



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 679 Akti

Nr. 448 Vendimi
Tiranë, më 21.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Etleda Çiftja	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 17.9.2021, ora 10:00, zhvilloi seancën dëgjimore dhe në datën 21.9.2021, ora 12:45, seancën për shpalljen e vendimit, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Erion Çelaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Erion Çelaj, si dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

- 1. Z. Erion Çelaj** është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Vlorë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit dhe aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë/komanduar si drejtues, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar” dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
- 2. Z. Erion Çelaj**, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Lulzim Hamitaj, Etleda Çiftja dhe Brunilda Bekteshi.
- 3. Menjëherë** pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31–33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.
- 4. Trupi gjykues i shortuar** në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) me vendimin e datës 12.01.2021, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisionerin Lulzim Hamitaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
- 5. Në datën 13.1.2021**, me anë të postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) fillimin e procesit të rivlerësimit; (ii) anëtarët e trupit gjykues të shortuar për të zhvilluar procesin e rivlerësimit; (iii) deklarin nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues; si dhe (iv) përgjigjet e pyetjeve të pyetësorit standard, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave, që kanë lidhje me

¹ *E-mail*, datë 13.1.2021, ora 12:15, “Komisioni – njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

procedurat e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi me anë të postës elektronike² se nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit shtesë dërguar me *e-mail*-in më lart, me anë të postës elektronike³, dërgoi përgjigje pyetësorit dhe dokumentacion bashkëlidhur.

7. Trupi gjykues, me vendimin e datës 29.7.2021, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Erion Çelaj, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

8. Në datën 30.7.2021, përmes postës elektronike⁴, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 20.8.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

9. Në datën 20.8.2021, subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike⁵, kërkoi shtyrjen e afatit të dërgimit të prapësimeve të tij, deri në datën 10.9.2021.

10. Trupi gjykues i Komisionit, bazuar në shkaqet e paraqitura nga subjekti, shtyu afatin e dorëzimit të prapësimeve deri në datën 6.9.2021, ora 11:00, si dhe njoftoi subjektin me anë të postës elektronike⁶. Më tej, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike⁷, paraqiti prapësimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

11. Më tej, në datën 10.9.2021, me anë të postës elektronike⁸, trupi gjykues, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore në datën 14.9.2021, ora 10:00, pranë Pallatit të Kongreseve, kati 0 (zero), Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Në datën 14.9.2021, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

²*E-mail*, datë 19.1.2021, ora 14:16, Re: “Komisioni – njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

³*E-mail*, datë 2.2.2021, ora 15:27.

⁴*E-mail*, datë 30.7.2021, ora 13:36, “Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

⁵*E-mail*, datë 20.8.2021, ora 19:59, Re: “Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

⁶*E-mail*, datë 25.8.2021, ora 14:19.

⁷*E-mail*, datë 7.9.2021, ora 11:39, Re: “Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

⁸*E-mail*, datë 10.9.2021, ora 13:33, “Komisioni – Ftesë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike”.

13. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ të kryer mbi kriterin e rivlerësimit të pasurisë.

14. Subjekti i rivlerësimit nuk ishte prezent, por përfaqësohej në këtë seancë nga përfaqësuesi i tij ligjor, z. E.Ç., me anë të prokurës së posaçme nr. ***, datë 14.9.2021, i cili kërkoi shtyrjen e kësaj seance dëgjimore, pasi nuk ishte njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit dhe rezultatet e hetimit.

15. Trupi gjykues u tërhoq në dhomë këshillimi dhe vendosi të shtyjë seancën dëgjimore të datës 14.9.2021, për t'i dhënë mundësi mbrojtësit të njihej me dosjen dhe rezultatet e hetimit, duke shtyrë zhvillimin e seancës dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Erion Çelaj më 17.9.2021, ora 10:00. Ky vendim iu komunikua përfaqësuesit ligjor të subjektit në seancën e datës 14.9.2020.

16. Në datën 17. 9.2021, subjekti i rivlerësimit bashkë me përfaqësuesin e tij ligjor, z. E.Ç., shprehu qëndrimin e tij, pasi dëgjoji relacionin, duke parashtruar prapësimet e tij lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht mbi kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

17. Në përfundim të seancës së datës 17.9.2021, kryesuesi i trupit gjykues, njoftoi se seanca për shpalljen e vendimit, do të vazhdojë në datën 21.9.2021.

18. Në datë 20.9.2021, trupi gjykues në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në përputhje me pikën 5, të nenit 5,5 të ligjit nr. 84/2016, diskutoi mbi vendimmarrjen dhe mori vendim për çështjen e subjektit Erion Çelaj.

19. Në datën 21.9.2021, trupi gjykues shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erion Çelaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Subjekti i rivlerësimit Erion Çelaj, ka qenë bashkëpunues gjatë procesit në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pasi përfundon shqyrtimi i dokumenteve ligjore të

përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e pesë dokumenteve sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

22. Referuar vendimit nr. 2/2017⁹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

23. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, Z. Erion Çelaj, e cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 për herë të parë, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

24. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2003- 2016 dhe referuar ligjit nr. 84/2016 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar: (a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (ç) nuk ka kryer deklaram të rremë; (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklaramet e përfaqësueses ligjore me prokurë në seancë dëgjimore.

⁹ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

26. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar në pikën 5, të nenit 33, ligjit nr. 84/2016.

27. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon: znj. L.Ç., bashkëshortja; z. Sh.I. (vjehtëri) konsiderohet person tjetër i lidhur si rezultat i dhurimit të apartamentit me sip. 116 m²; z. A.I. (kunati) konsiderohet person tjetër i lidhur, si rezultat i dhurimit të shumës 6.000 euro në favor të fëmijëve të subjektit, për hapjen e dy depozitave bankare për secilin.

28. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

1. Apartament me sip. 116 m², Tiranë, në vlerën 48.000 euro

1.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron apartament banimi me sip. 116 m², nr. pasurie *** (pallat) sh. ***, k. ***, ap. ***, S., Tiranë, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 10.5.2012. Vlera: 48.000 Euro. Pjesa takuese nuk është përcaktuar. Si burim krijimi, subjekti deklaroi: Kjo pasuri është përfituar sipas aktmarrëveshjes së porosisë të të ndjerit babait të bashkëshortes Sh.I. me shoqërinë “****” sh.p.k. Për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁰.

1.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar banesë me sip. 116 m², në S., Tiranë, përfituar nga babai i bashkëshortes. Vlera: 48.000 euro.

1.3. Referuar përgjigjes së ASHK-së Tiranë¹¹, kjo pasuri nuk rezulton e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, por konfirmon se në emër të subjektit Erion Çelaj, figurojnë të regjistruara pasuritë: (i) nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë “apartament”, me sip. 62 m², vërtetuar me kartelën e pasurisë, data e regjistrimit 26.7.2017, me shënim “ndarje pasurie”; dhe (ii) nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i

¹⁰Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.11.2016, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, lloji “apartament”, me sip. 116 m², regjistruar në datën 31.5.2012, në emër të shtetasit Erion Çelaj, kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, lloji “apartament” me sip. 116 m², regjistruar në datën 10.11.2010, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., kërkesë për aplikim pranë ZVRPP-së Tiranë, për regjistrim të pasurisë nr. ***, në emër të shtetasit Erion Çelaj, shoqëruar me mandatpagesat bankare për pagesat e detyrimeve tatimore, kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 10.5.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palës blerëse Erion Çelaj, bashkëlidhur ekstrakti historik i shoqërisë “****” sh.p.k., certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.11.2010, të pasurisë nr. ***, lloji “apartament”, me sip.116 m², në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., aktmarrëveshje kryerje punimesh instalime elektrike, datë 11.10.2007, nënshkruar ndërmjet palës porositëse shoqërisë “****” sh.p.k. dhe palës sipërmarrëse shoqërisë “****” sh.p.k., deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.3.2016, nga shtetasi Sh.P., deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.3.2016, nga shtetasja T.I.

¹¹Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021.

pasurisë apartament, me sip. 54 m², vërtetuar me kartelën e pasurisë, data e regjistrimit 26.7.2017, shënim “ndarje pasurie”.

1.4. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se ASHK-ja Tiranë, me anë të urdhrin nr. ***, datë 14.8.2017, sipas kërkesës së subjektit, datë 21.6.2017, ka bërë ndarjen e kësaj pasurisë me sip. totale 116 m² në dy pasuri të llojit apartament, me sip. 1. 62 m² dhe sip. 2. 54 m².

1.5. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar shkresën nr. *** prot., datë 8.11.2016, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, ku konfirmohet se në emër të tij figuron e regjistruar pasuria nr. ***, e llojit apartament, me sip. 116 m², vol. ***, f. ***, z. k. ***. Vërtetuar kjo me kartelën e pasurisë, regjistruar në datën 31.5.2012, në emër të subjektit Erion Çelaj.

1.6. Ky apartament është blerë me kontratën nr. ***, datë 10.5.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse shoqërisë “****” sh.p.k. dhe palës blerëse Erion Çelaj, për apartamentin e ndodhur në S., me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 116 m², në shumën 48.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Sipas certifikatës së pronësisë nr. ***, datë 18.11.2010, kjo pasuri ka qenë e regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

1.7. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar një “*akt marrëveshje për kryerje punimesh instalime elektrike*” të datës 11.10.2007, dokument i thjeshtë, jo i përpiluar para noterit publik, nënshkruar ndërmjet palës porositëse shoqërisë “****” sh.p.k. dhe palës sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k., me administrator shtetasi Sh.P. dhe palë tjetër sipërmarrëse shtetasi Sh.I. (vjehtëri i subjektit). Sipas kësaj marrëveshje shoqëria “****” sh.p.k. është duke ndërtuar një kompleks banimi dhe pala sipërmarrëse do të kryejë për llogari të palës porositëse punimet e pajisjes së kompleksit të banimit me instalimet elektrike, kundrejt vlerës totale prej 94.000 euro. Likuidimi i pagesave të punimeve do të kryhet me kalimin në pronësi të shumës së caktuar ose dy apartamente me sip. 116 m², në pronësi të porositësit. Palët bien dakord që këto apartamente të vlerësohen me vlerën prej 47.000 euro secili. Sipërmarrësi do të kryejë punimet në afatin kohor prej 60 ditësh kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Në këtë aktmarrëveshje është përcaktuar se porositësi në fund të kryerjes së punimeve, të ndjek procedurat ligjore për kalimin e pronësisë së apartamenteve nr. ***, z. k. ***, me sip. 116 m², në pronësinë e sipërmarrësve shoqëria “****” sh.p.k. dhe shtetasit Sh.I.

1.8. Më tej, subjekti ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.3.2016, të lëshuar nga shtetasi Sh.P., i cili deklaron se rreth viteve 2006-2007, së bashku me shtetasin Sh.I. kanë marrë përsipër kryerjen e punimeve elektrike në pallatet e ndërtuara nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe, për këtë arsye, u është vënë në dispozicion sipërfaqja ndërtimore 116 m², por në këtë periudhë shtetasi Sh.I. ka ndërruar jetë. Z. Sh.P. deklaron se duke qenë se ka pasur marrëdhënie të mira shoqërore me familjarët e tij këtë apartament e ka marrë dhëndri i z. Sh.I., subjekti Erion Çelaj, i cili ka nënshkruar kontratën dhe dokumentacionin për kalimin e pronësisë së apartamentit në emrin e tij. Sipas deklaratës, z. Sh.I., kishte shprehur dëshirën që apartamentin që përfitoi nga kjo punë, do t’ia kalonte dhëndrit dhe vajzës.

1.9. Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.3.2016, lëshuar nga shtetasja T.I., e cila rikonfirmon marrëveshjen që kishte nënshkruar bashkëshorti i saj i ndjerë Sh.I. me shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe deklaron se apartamenti i përfituar sipas aktmarrëveshjes me sip. 116, m², sipas vullnetit të bashkëshortit të saj, ka kaluar në emër të

dhëndrit të tyre Erjon Çelaj, sipas kontratës, nr. ***, datë 10.5.2012. Znj. T.I. thekson se banon aktualisht në këtë apartament dhe se faturat e energjisë elektrike dhe ujit janë paguar rregullisht prej saj.

1.10. Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 26.2.2016, subjekti është pyetur lidhur me burimin e këtij apartamenti, pasi në DIPP-në e vitit 2012 deklaroi se është dhuruar nga vjehri i tij, ndërkohë që rezultoi i blerë nga subjekti me kontratën nr. ***, datë 10.5.2012. Subjekti ka deklaruar se: *“Babai i bashkëshortes, shtetasi Sh.I., ka punuar në fushën e instalimeve elektrike së bashku me shtetasin Sh.P., me të cilin kishin lidhje të vjetër miqësore. Sh.P. ka pasur aktivitet të regjistruar në QKR për kryerje punimesh, instalime elektrike etj. dhe kanë punuar së bashku. Për punimet që kanë kryer te firma ‘***’ kanë pasur marrëveshje për të përfituar jo vlerë parash por sipërfaqe ndërtimore (hyrje), të cilat me përfundimin e ndërtimit të objektit do të bëheshin pronë e tyre. Ndërkohë kur bëheshin procedurat e regjistrimit të ndërtimit fillimisht në emrin e shoqërisë dhe më pas kalimi në emrin e vjehrit, ky i fundit ka ndërruar jetë, dhe jam vënë në dijeni nga familjarët dhe nga Sh.P. se dëshira e tij ishte që këtë apartament ta merrte për familjen e së bijës, pra unë duhej të shkoja pranë shoqërisë ndërtuese për të nënshkruar kontratën përfundimtare. Aktualisht në këtë apartament banon nëna e bashkëshortes shtetasja T.I., e cila paguan energjinë dhe ujin. Mobilimi dhe kompletimi është bërë prej tyre”.*

1.11. QKB-ja¹² bën me dije se i ndjeri Sh.I. nuk figuron në regjistrin tregtar.

1.12. ISSh-ja¹³ ka përcjellë të dhëna lidhur me punësimin përpara vitit 1983, ku ky shtetas figuron me profesion elektrikist.

1.13. Referuar ekstraktit historik të shoqërisë “***” sh.p.k., me NIPT ***, themeluar në datën 9.10.2007 dhe regjistruar në datën 11.10.2007 (datën e nënshkrimit të marrëveshjes), shtetasi Sh.P., figuron administrator dhe ortak i vetëm, me 100 % pjesë të kapitalit. Në faqen zyrtare të QKB-së ndodhet edhe akt themelimi i kësaj shoqërie, datë 25.6.2008, ku në cilësinë e themeluesit të shoqërisë paraqitet shtetasi Sh.P.

1.14. Komisioni vëren se kontrata e shitblerjes është nënshkruar vetëm nga subjekti i rivlerësimit, i cili zotëron 100% të apartamentit me sip. 116 m² dhe nuk është shprehur që është rrjedhim i aktmarrëveshjes, ndërkohë që në deklaratën *Vetting*, subjekti deklaroi se kjo pasuri është përfituar sipas aktmarrëveshjes së porosisë të të ndjerit babait të bashkëshortes Sh.I. me shoqërinë “***” sh.p.k. Gjithashtu, në kontratën e shitjes nuk specifikohet mënyra e pagesës e përcaktuar në aktmarrëveshje. Për sa rezultoi, Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1¹⁴, kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues për apartamentin e përfituar nga shtetasi Sh.P., sipas aktmarrëveshjes së nënshkruar me shoqërinë “***” sh.p.k.

1.15. Gjithashtu, duke qenë se referuar aktmarrëveshjes së datës 11.10.2007, është e paqartë nëse do të përfitohen dy apartamente me sip. 116 m², apo një për të dy së bashku (shtetasi

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 13.1.2021.

¹³Shkresë nr. *** prot., datë 21.1.2021, nga Drejtoria e Arkivit Qendror Lundër.

¹⁴E-mail datë 4.6.2021, ora 16:13.

Sh.P., përfaqësues i shoqërisë “****” sh.p.k. dhe i ndjeri Sh.I.), Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1, kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit.

1.16. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹⁵, subjekti deklaroi se apartamenti me sip. 116 m² është përfutur bazuar në aktmarrëveshjen e datës 11.10.2007, të lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. Sh.I. në cilësinë e sipërmarrësve. Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 10.5.2012, është nënshkruar ndërmjet subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., kundrejt çmimit prej 48.000 euro, si rezultat i kompensimit të shërbimit që vjehri i subjektit ka kryer për punimet elektrike në pallatin e ndodhur në S., Komuna Farkë. Në kohën kur vjehri i tij ishte në gjendje të rëndë shëndetësore, vijon subjekti, apartamentin që kishte përfutur nga puna e kryer, kishte dëshirë që t’ia dhuronte vajzës së tij, pra, bashkëshortes së subjektit, pikërisht, për faktin e lëndimit të tij të thellë nga problemet shëndetësore që kishin me djalin e tyre J.

1.17. Subjekti deklaroi se në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk i ka kushtuar rëndësi përmbajtjes së saj, pasi nuk kishte dhënë asnjë shumë të hollash për këtë apartament dhe e dinte qartësisht se vinte si rezultat i punës së kryer nga vjehri i tij i ndjerë. Bashkëshortja e subjektit nuk mund të vinte në Tiranë, në pamundësi, si rezultat i impenjimit me familjen. Më tej, shpjegon se të njëjtën gjë ka deklaruar në DPV-në e vitit 2012, në deklaratën *Vetting*, si dhe në procesverbalin e datës 26.2.2016, mbajtur në ILDKPKI. Nisur nga konstatimi i Komisionit se në kontratë nuk është shprehur që kalimi i pronësisë vjen si rrjedhim i aktmarrëveshjes së datës 11.10.2007, subjekti sqaron se i ka kërkuar informacion shoqërisë “****” sh.p.k. dhe ka dorëzuar në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.6.2021.

1.18. Sipas kësaj deklarate shtetasi R.Z., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. deklaroi se në cilësinë e porositësit në datën 11.10.2007, ka lidhur një marrëveshje për kryerjen e punimeve elektrike me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe z. Sh.I. Është rënë dakord që pagesa për këto punime është në vlerën 94.000 euro ose me kalimin në pronësi të dy apartamenteve, përkatësisht me sip. 116 m², në vlerën 47.000 euro secili. Punimet e kërkuara u përmbushën rregullisht sipas aktmarrëveshjes. Pas përfundimit të objektit në S., Tiranë, në z. k. ***, shoqëria realizoi regjistrimin e plotë të objektit në ZVRPP-në Tiranë. Në përmbushje të detyrimeve kontraktore, z. Sh.I., i takonte apartamenti me numër pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. *** dhe familjarët i kanë dhënë pëlqimin për kalimin e pronësisë dhëndrit, z. Erion Çelaj. Në lidhje me diferencën në çmimin prej 1.000 euro, deklarohet se në këtë apartament janë kryer punime ekstra, të tilla si punime gipsi, pllaka dhe hidrosanitare jashtë projektit fillestar. Shtetasi R.Z. deklaroi se vlera e përcaktuar në kontratën e shitjes nuk është paguar nga blerësi, detyrimi është përmbushur bazuar në aktmarrëveshjen e sipërpërmendur, për punimet e kryera nga z. Sh.I., si palë sipërmarrëse për shoqërinë “****”, si palë porositëse dhe e quan të përmbushur çdo marrëdhënie detyrimi me z. Sh.I. dhe familjarët e tij.

1.19. Me anë të pyetësorit nr. 1, Komisioni kërkoi dokumentacion ligjor justifikues lidhur me marrëdhënien tregtare midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****”, të tilla si akt rakordime, fatura shitje etj. Në përgjigje, subjekti bëri me dije se i është drejtuar me shkresë zyrtare dy shoqërive për t’i vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, të cilin do t’ia përcjellë Komisionit sapo ta administrojë.

¹⁵E-mail datë 21.6.2021, ora 21:43.

1.20. Pasi u analizuan shpjegimet e subjektit, Komisioni vëren se në aktmarrëveshjen e lidhur është përcaktuar se në favor të sipërmarrësit shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit Sh.I. do të kalojë apartamenti me sip. 116 m², nr. ***, z. k. *** (pra, apartamenti që është në pronësi të subjektit) dhe nuk është specifikuar apartamenti tjetër që do të përfitonte shoqëria “****” sh.p.k., sipas deklarimeve të shtetasit R.Z. Evidentohet se subjekti nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues për apartamentin e përfituar nga shtetasi Sh.P., sikundër iu kërkua nga Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1.

1.21. Në këto kushte, subjekti u ripyet me anë të pyetësorit nr. 2 dhe në përgjigje deklaroi se ka qenë në pritje që shoqëritë e mësipërme t’i vinin në dispozicion dokumentacionin e kërkuar. Nga kërkimet e bëra prej tij dhe përgjigjet e marra prej tyre, për shkak të kohës së largët që ka kaluar, nuk rezulton të kenë gjetur fatura apo situacione të ruajtura për periudhën e kërkuar. Në lidhje me mënyrën e pagesës, sipas subjektit shoqëritë deklarojnë se janë shlyer në vijimësi, rast pas rasti, duke theksuar se marrëdhënia e tyre tregtare ka vijuar edhe aktualisht. Subjekti deklaron se është në pamundësi objektive për të vendosur në dispozicion dokumentacion e kërkuar për të cilin nuk ka pasur dijeni dhe nuk është përgjegjës. Subjekti në cilësinë e provës, vuri në dispozicion shkresën e datës 29.6.2019, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k.

1.22. Sa më sipër, Komisioni vëren se shoqëria “****” sh.p.k. ka dhënë të njëjtën përgjigje sikundër dhe në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Komisioni¹⁶, ku deklarohet se pagesa për punimet e kryera është dakordësuar për vlerën 94.000 euro ose me kalimin në pronësi të dy apartamenteve përkatësisht me sip. 116 m², me vlerë 47.000 euro/secili. Lidhur me kërkesën e Komisionit, për të vënë në dispozicion faturat/situacionet për këto punime, deklarohet se nuk disponohen për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të ruajtjes së dokumentacionit kontabël, bazuar në ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

1.23. Në shpjegimet e tij, subjekti deklaron se nuk ka dhënë asnjë shumë të hollash për këtë apartament, ndërkohë që shtetasi R.Z. deklaron diferencën në çmimin prej 1.000 euro më shumë, si rezultat i punimeve ekstra jashtë projektit fillestar, vlerë e cila nuk është deklaruar nga subjekti.

1.24. DPPPP-ja, me shkresën nr. ***, datë 21.1.2021, konfirmon se subjekti Erion Çelaj në datën 14.6.2012 ka kryer transaksion në vlerën 48.000 euro në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., për blerjen e një apartamenti me kontratën nr. ***.

1.25. Për të provuar marrëdhënien tregtare midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.p.k., Komisioni kërkoi informacion pranë DRT-së Elbasan, duke i kërkuar të vendosë në dispozicion librat e shitjeve të shoqërisë “****”, për periudhën 2006 – 2008, si dhe akt-kontrollet e ushtruara në këtë subjekt tregtar për të njëjtën periudhë.

1.26. DRT-ja Elbasan¹⁷ përcolli librin e shitjeve për muajin dhjetor 2007, ku nuk figuron blerës shoqëria “****” sh.p.k. Vlera pa TVSH e pasqyruar në librin e shitjes për muaji dhjetor 2007 përkon me qarkullimin për vitin 2007 referuar pasqyrave financiare dhe, për rrjedhojë, për periudhën e mëparshme (11.10.2007 – 30.11.2007) nuk duhet të ketë pasur furnizime të tjera prej saj. Ndërsa për vitin 2008, DRT-ja Elbasan nuk përcolli informacion. Gjithashtu, në

¹⁶Shkresë e datës 28.6.2021, e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.6.2021.

¹⁷Shkresë nr. ***, datë 9.6.2021.

dokumentacionin e administruar u konstatua se i ndjeri, shtetasi Sh.I., nuk figuron në listën e personave të punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k.

1.27. Sa më lart, nuk provohet që midis shoqërisë “****” sh.p.k. nga njëra anë dhe shoqërisë “****” sh.p.k. dhe të ndjerit Sh.I. nga ana tjetër, ka ekzistuar një marrëdhënie tregtare dhe, po kështu, subjekti nuk paraqiti dokumentacion shtesë për të provuar këtë marrëdhënie.

Lidhur me pasqyrimin e numrit të pasurisë (apartamentit të subjektit) në aktmarrëveshjen për kryerje punimesh instalime elektrike të datës 11.10.2007

1.28. Komisioni vëren se akt-marrëveshja e paraqitur nga subjekti, e lidhur në datë **11.10.2007**, ka të përcaktuar numrin e pasurisë së apartamentit që do të përfitohej, konkretisht pasuri me nr. ***, z. k. ***.

1.29. Në pyetësin nr. 2, subjekti deklaroi se në dijeninë e tij, nga informacioni që ka marrë nga familjarët, por edhe sikurse ka deklaruar edhe përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k. në deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.7.2021, apartamenti i përfituar nga vjehri i tij, i ndjeri Sh.I., është marrë në objektin ku janë kryer punimet elektrike.

1.30. Nga dokumentacioni i vëzhguar në sistemin multifunksional të ASHK-së, rezulton se objekti ku ndodhet apartamenti i përfituar nga subjekti është pajisur me “leje ndërtimi nr. ***, datë 22.4.2005, miratuar me vendimin nr. 1, datë 6.2.2004, të kryetarit të Komunës Farkë” (të cilat gjithashtu citohen në aktmarrëveshjen e datës 11.10.2007), bazuar në aktkolaudimin e dorëzuar punimet kanë filluar në maj 2006 dhe kanë përfunduar në shkurt 2008, akti teknik nr. ***, “Për zbatimin e detyrave të lëna dhe lejimin e shfrytëzimit të objektit”, mban datën 13.3.2008 dhe leja e shfrytëzimit të këtij pallati është lëshuar në datën 4.9.2008.

1.31. Në këto kushte, Komisioni mori në shqyrtim legjislacionin përkatës për të verifikuar se në cilin moment përcaktohet numri unik i regjistrimit të një pasurie të paluajtshme.

1.32. Bazuar në rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999, “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, është përcaktuar se regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme bëhet me përgatitjen e kartelave të pasurive të paluajtshme dhe dokumentimin e kufijve të këtyre pasurive në hartën treguese të regjistrimit. Mënyra e Regjistrimit Fillestar - Të drejtat e pronësisë, si dhe kufijtë e çdo pasurie të paluajtshme, vërtetohen me paraqitjen në ZVRPP të dokumenteve të mëposhtme: (i) kontrata e shitjes së truallit midis Këshillit të Rrethit/Bashkisë dhe blerësit; (ii) leje për sheshin e ndërtimit e dhënë nga organi kompetent; (iii) leja e ndërtimit miratuar nga KRRT-ja; (iv) akti i kolaudimit të objektit; (v) leja e shfrytëzimit ose e banimit të objektit; (vi) planvendosja miratuar nga KRRT-ja; (vii) dokumente të tjera që përcaktojnë dhe individualizojnë objektin e ndërtuar. Gjithashtu, kjo rregullore parashikon se çdo pasuri e paluajtshme ka një numër unik brenda zonës kadastrale.

1.33. Bazuar në nenin 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, dhënia e lejes së përdorimit bëhet nga autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit brenda 30 ditëve pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit. Autoriteti përkatës i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit i dërgon zyrtarisht Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në juridiksionin e së cilës ndodhet objekti, konfirmimin zyrtar të përfundimit të punimeve të ndërtimit të objektit në përputhje me ligjin, projektin dhe kushtet urbanistike të miratuara për sheshin e

ndërtimit. Këtij dokumenti i bashkëngjiten kopjet e akteve vijuese: (i) leja e zhvillimit; (ii) leja e ndërtimit; (iii) procesverbali i kolaudimit të objektit; (iv) leja e përdorimit; (v) plani i vendosjes së objektit; si dhe (vi) dokumente të tjera që përcaktojnë dhe individualizojnë objektin e ndërtuar.

Me paraqitjen e këtij dokumentacioni, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me dispozitat ligjore, kryen veprimet përkatëse të regjistrimit të objektit dhe lëshon certifikatën e pronësisë të të interesuarit.

1.34. Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 7720, datë 14.6.1993, “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve”, dhënia e lejes së shfrytëzimit ose të banimit bëhet nga seksioni i urbanistikës pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit¹⁸.

1.35. Referuar dispozitave të analizuara më sipër, numri i pasurisë përcaktohet vetëm pasi janë depozituar dokumentet përkatëse, ndër to, akti i kolaudimit, situacioni përfundimtar i punimeve, aktet teknike dhe, më pas, akordohet leja e shfrytëzimit/përdorimit të objektit për regjistrimin në ZVRPP.

1.36. Aktmarrëveshja e paraqitur nga subjekti është lidhur në datën 11.10.2007 dhe ka të përcaktuar numrin e pasurisë së apartamentit që do të përfitohet, çka nënkupton që objekti është regjistruar në ZVRPP, kur ndërkohë leja e shfrytëzimit të këtij pallati, rezulton të jetë lëshuar më vonë, në datën 4.9.2008.

1.37. Parashikimi i numrit të pasurisë që në datën 11.10.2007 nuk duket të ketë qenë i mundur, pasi bie në kundërshtim me legjislacionin e kohës në fuqi dhe me procedurat e vendosura, për sa kohë aktkolaudimi i objektit duhet të përfshijë të gjitha punimet e kryera, situacionin përfundimtar të punimeve (përfshirë ato elektrike) dhe, më pas, të kryhen procedurat për lëshimin e lejes së shfrytëzimit/përdorimit dhe hapi përfundimtar regjistrimi i objektit në ZVRPP, i cili përcakton dhe numrin unik të pasurisë.

1.38. Sa më lart, ngrihen dyshime mbi momentin e përpilimit dhe vërtetësinë e aktmarrëveshjes dhe ekzistencën e saj që në vitin 2007 dhe mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit.

1.39. Për rrjedhojë, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e këtij apartamenti, në vlerën 48.000 euro, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të

¹⁸Sipas VKM-së nr. 672 datë 29.07.2015 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”; në nenin 27 përcaktohet se në përfundim të procesit të zhvillimit, aplikuesi paraqet kërkesën për t’u pajisur me certifikatë përdorimi, së bashku me procesverbalin e kolaudimit dhe dokumentacionin shoqëruar, përfshirë deklaratën teknike se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi, pranë autoritetit të zhvillimit. - Dokumentet për pajisjen me certifikatë përdorimi janë si vijon: c) procesverbali i kolaudimit...; ... e) situacioni përfundimtar i punimeve; ë) aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.), të lëshuara nga shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, 33 institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane;¹⁸ Sipas udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, në kreu II - Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, në pikën 3, është përcaktuar se kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi: a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

1.40. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *Duket se nuk provohet se apartamenti në pronësi të subjektit është përfutur nga ana e të ndjerit/vjehrrit të tij, pasi: (a) krijohen dyshime lidhur me vërtetësinë e aktmarrëveshjes së paraqitur, pasi në datën e lidhjes së saj (më 11.10.2007) është përcaktuar numri i pasurisë së paluajtshme, ndërkohë që dokumentacioni i domosdoshëm për regjistrimin përfundimtar të pasurisë në regjistrat publikë, që bën të mundur përcaktimin e numrit unik të pasurisë, është lëshuar më vonë (sipas kartelës së pasurisë¹⁹ në datën 10.11.2010); (b) në kontratën e shitjes nuk është përcaktuar që përfitimi i këtij apartamenti është si rezultat i aktmarrëveshjes së lidhur në vitin 2007; (c) nuk provohet ekzistenca e një marrëdhënie tregtare midis shtetasi Sh.I. dhe shoqërisë “*” sh.p.k., nga njëra anë dhe shoqërisë “***” sh.p.k. nga ana tjetër; (ç) nuk provohet përfitimi i një apartamenti tjetër nga shtetasi Sh.P., një nga palët sipërmarrëse sipas parashikimit në aktmarrëveshjen e lidhur në datën 11.10.2007; (d) përfitimi i kësaj pasurie nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, pasi e drejta për të trashëguar të ndjerin Sh.I., i takon fëmijëve dhe bashkëshortes, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta; (dh) në DIPP-në e vitit 2012, subjekti nuk ka përshkruar në mënyrë të plotë aktin me anë të të cilit e ka përfutur këtë pasuri. (ii) Ka mospërputhje ndërmjet deklarimeve të subjektit, i cili deklaroi se nuk ka paguar asnjë shumë të hollash për apartamentin me sip. 116 m², në S., Tiranë, ndërkohë që: (a) në kontratën e blerjes përcaktohet se është paguar e gjithë shuma prej 48.000 euro; dhe (b) nga ana tjetër shtetasi R.Z. deklaroi diferencën në çmimin prej 1.000 euro më shumë, si rezultat i punimeve ekstra jashtë projektit fillestar. (iii) Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e këtij apartamenti, për sa kohë nuk provohet mënyra e përfutimit të kësaj pasurie***

1.41. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: “[...] nuk e kam disponuar aktmarrëveshjen deri në momentin e dorëzimit të saj në vitin 2016 pranë ILDKPKI-së, pasi kjo marrëdhënie është zgjidhur financiarisht që në vitin 2007 me kryerjen e punimeve dhe kam rënë në dijeni të situatës financiare vetëm në vitin 2012 kur jam lajmëruar nga shtetasi Sh.P. për kryerjen e veprimeve noteriale dhe kalimit të pronësisë për këtë apartament [...]”.

1.42. Aktmarrëveshja është firmosur prej vjehrrit të tij dhe përfaqësuesve të shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. Numri i pasurisë i parashikuar në aktmarrëveshje është bërë sipas listës së njësisive të përcaktuara që në momentin e ndërtimit dhe të dorëzuara në kohë në Komunën Farkë. Ka pasur një rend kronologjik për parashikimin e numrit të pasurisë. Shoqëria “****” sh.p.k. ka paraqitur kërkesë për pajisjen me certifikatë pronësie në datën 22.9.2008 dhe certifikata e pronësisë për apartamentin është lëshuar në datën 18.11.2010. Që nga data e lëshimit të certifikatës kjo pasuri ka ngelur në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., deri në momentin kur është kërkuar me ngulm që të paraqitej për të kryer veprimet e kalimit të pronësisë.

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2016.

1.43. Fakti se kontrata e shitblerjes nuk referon aktmarrëveshjen (në kushtet kur kontratat ishin Tip të përgatitura paraprakisht nga shoqëria) ka ndodhur për shkak të mospagimit të detyrimeve tatimore, konkretisht tatimit në burim që shoqëria “****” sh.p.k. duhet të paguante për të ardhurat nga shërbimi që vjehri i subjektit kishte kryer për punimet elektrike. Gjithashtu, në atë kohë nuk njiheshin edhe transaksionet e *kleringut* dhe nuk përfshiheshin në mënyrën e likuidimit të blerjes së pasurisë në kontratën përfundimtare të shitblerjes

1.44. Në vitin 2012, në momentin e kalimit të pronësisë, që konsiderohet edhe momenti i pagesës, shoqëria “****” sh.p.k. do të duhej të paguante tatimin në burim në shkallën 10%, sipas legjislacionit të kohës për të ardhurat e realizuara nga shërbimi i kryer për punimet elektrike. Kështu për pagesën *neto* në shumën 47.000 euro shoqëria do të duhej të paguante shumën 5.222 euro tatim në burim. Në kohën që subjekti e ka firmosur këtë kontratë nuk i kishte kushtuar rëndësi përmbajtjes, pasi ishte i qetë për mënyrën e përfitimit të këtij apartamenti.

1.45. Fakti i mosparaqitjes së faturave ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.p.k. për të provuar marrëdhënien tregtare është vetëm për arsyen e faturimit të vlerës së plotë të shërbimit ose jo. Duket e pakuptimtë që shoqëria “****” sh.p.k., në vitin 2008 të ketë një vlerë shitjesh *neto* vjetore prej 22.425.299 lekësh dhe mos të gjejë fizikisht faturat. Madje këto fatura nuk gjenden as tek shoqëria blerëse “****” sh.p.k. Sipas subjektit shoqëritë nuk kanë faturuar vlerën e plotë të shërbimit, por do të kenë faturuar një pjesë të tyre dhe, për këtë arsye, nuk paraqesin fare fatura. Gjithashtu, nuk kanë paraqitur as procesverbale apo dokumente të tjerë të cilat duhet të jenë mbajtur gjatë kohës së kryerjes së punimeve. Ka një mungesë të theksuar bashkëpunimi me këto dy shoqëri sa edhe informacionin dhe dokumentacionin e dhënë deri më tani e ka pasur të vështirë ta sigurojë.

1.46. Në seksionin e analizës financiare, subjekti deklaroi se balanca negative e vitit 2012 nuk qëndron edhe për faktin se nuk ka fluks dalëse për blerjen e kësaj pasurie dhe se mënyra e likuidimit të saj është përcaktuar që në vitin 2007, ndërsa kalimi i pronësisë në vitin 2012.

1.47. Si konkluzion, subjekti deklaroi se e ka deklaruar rregullisht këtë apartament si burimin e përfitimit në DPV-në e vitit 2012, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*. Në këto kushte, duke vlerësuar se detyrimi për të paguar detyrimeve tatimore është i shoqërisë “****” sh.p.k., vlerëson se Komisioni duhet të analizonte vlerën e kësaj pasurie nën dritën e konceptit të dyfishit të pasurisë së ligjshme. Informaliteti është pikërisht një nga arsyet kryesore për parashikimin e konceptit të dyfishit të pasurisë së ligjshme në Aneksin e Kushtetutës dhe në rastin konkret të ardhurat janë përfituar nga vjehri dhe subjekti së bashku me bashkëshorten e tij ka përfituar të drejtat pasurore të vjehrit (sipas amanetit të lënë prej tij, marrëdhënie që njihet nga e drejta zakonore shqiptare). Trashëgimtarët e tjerë e njihnin vullnetin e vjehrit të tij në momentet përpara se të ndërronte jetë dhe kanë hequr dorë nga të drejtat pasurore që rridhnin nga puna e tij në vitin 2007-2008.

1.48. Subjekti paraqiti në cilësinë e provës: (i) kërkesë drejtuar shoqërisë “****” sh.p.k. për vendosje në dispozicion të pasqyrave financiare; (ii) kthim përgjigje nga shoqëria “****” sh.p.k. së bashku me dokumentacionin shoqëruar; dhe (iii) kopje të certifikatës së pronësisë nr. *** lëshuar në vitin 2010.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.49. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.50. Lidhur me pretendimi i subjektit se *numri i pasurisë i parashikuar në aktmarrëveshje është bërë sipas listës së njëjësive të përcaktuara që në momentin e ndërtimit dhe të dorëzuara në kohë në Komunën Farkë* nuk është i bazuar në rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999, “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, në të cilën është përcaktuar se regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme bëhet me përgatitjen e kartelave të pasurive të paluajtshme dhe dokumentimin e kufijve të këtyre pasurive në hartën treguese të regjistrimit, duke përcaktuar dhe mënyrën e regjistrimit, që në rastin konkret nevojitej akti i kolaudimit të objektit dhe leja e shfrytëzimit, të cilat janë miratuar në vitin 2008 dhe jo 2007, kur pretendohet se është nënshkruar aktmarrëveshja. Gjithashtu, në këtë rregullore parashikohej se çdo pasuri e paluajtshme ka një numër unik brenda zonës kadastrale, çka tregon se nuk ishte e mundur të kishte numër të saktë të pasurisë në vitin 2007, sipas datës që mban aktmarrëveshja. Parashikimi i numrit të pasurisë që në datën 11.10.2007 nuk duket të ketë qenë i mundur, pasi bie në kundërshtim me legjislacionin e kohës në fuqi dhe me procedurat e vendosura dhe duket teknikisht i vështirë ose i pamundur gjerimi paraprak i një numri pasurie, për sa kohë aktkolaudimi i objektit duhet të përfshijë të gjitha punimet e kryera, situacionin përfundimtar të punimeve (përfshirë ato elektrike) dhe më pas të kryhen procedurat për lëshimin e lejes së shfrytëzimit/përdorimit dhe hapi përfundimtar regjistrimi i objektit në ZVRPP, i cili përcakton dhe numrin unik të pasurisë.

1.51. Pretendimi i subjektit se *kontrata e shitblerjes nuk referon akt marrëveshjen (në kushtet kur kontratat ishin Tip të përgatitura paraprakisht nga shoqëria) për shkak të mospagimit të detyrimeve tatimore, konkretisht tatimit në burim që shoqëria “****” sh.p.k. duhet të paguante për të ardhurat nga shërbimi që vjehri im kishte kryer për punimet elektrike*, nuk u provua me dokumentacion provues nga subjekti, për aq sa kjo aktmarrëveshje është dhe prova thelbësore që vërteton burimin e krijimit të kësaj pasurie nga i ndjeri vjehri i subjektit sipas deklaratimit të tij. Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provojë ekzistencën e një marrëdhënie tregtare midis shtetasit Sh.I. (vjehri i subjektit) dhe shoqërisë “*****” sh.p.k. nga njëra anë dhe shoqërisë “****” sh.p.k., nga ana tjetër, për më tepër që gjatë hetimit nuk u provua dhe zbatimi i kësaj aktmarrëveshjeje për përfitim të një apartamenti tjetër nga shtetasi Sh.P., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., një nga palët sipërmarrëse sipas parashikimit në aktmarrëveshjen e lidhur në datën 11.10.2007.

1.52. Vetëm vlera e shitjeve në pasqyrat financiare të vitit 2008 të shoqërisë “****” sh.p.k., pasqyra të cilat nuk janë të njehsuara nga zyra rajonale tatimore përkatëse, nuk mund të provojë se këto shitje janë kryer për shoqërinë “****” sh.p.k.

1.53. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi bindshëm dhe me dokumentacion ligjor justifikues dhe konstatimin e Komisionit se përfitimi i kësaj pasurie nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, pasi e drejta për të trashëguar pasuritë, të drejtat dhe detyrimet e të ndjerin Sh.I., i takojnë fëmijëve dhe bashkëshortes, duke trashëguar secili

në pjesë të barabarta dhe jo bashkëshortit të vajzës. Për më tepër që subjekti i rivlerësimit në vitin 2012, kur është bërë nënshkrimi i kontratës së shitblerjes, nuk ka shpjeguar në mënyrë të plotë aktin me anë të të cilit e ka përfituar këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2012, duke mbetur kështu një boshllëk, lidhur me legjitimitetin e përfitimit të kësaj pasurie në favor të tij dhe të regjistruar në emër të tij bazuar mbi një kontratë fiktive, që përshkruante një blerje dhe jo një dhurim apo trashëgim, siç pretendohet nga subjekti.

1.54. Më tej, Komisioni, gjithashtu, vlerëson se subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm mospërputhjen ndërmjet deklarimeve të tij gjatë hetimit se nuk ka paguar asnjë shumë të hollash për apartamentin me sip. 116 m², në S., ndërkohë që: (a) në kontratën e blerjes përcaktohet se është paguar e gjithë shuma prej 48.000 euro; dhe (b) nga ana tjetër shtetasi R.Z. deklaron diferencën në çmimin prej 1.000 euro më shumë, si rezultat i punimeve ekstra jashtë projektit fillestar dhe, për këtë arsye, Komisioni i qëndron konstatimit në rezultatet e hetimit.

1.55. Bazuar në vlerësimin më lart, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm as legjitimitetin e tij për të përfituar këtë pasuri dhe as burimin e ligjshëm të këtij apartamenti dhe të ardhurat e ligjshme të përfituara nga vjehri për përfitimin e kësaj pasurie, sipas kërkesave të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e këtij apartamenti, në të gjithë vlerën e tij, për sa kohë subjekti nuk provoi burimin e ligjshëm të përfitimit të kësaj pasurie.

1.56. Në përfundim të vlerësimit të kësaj pasurie, për efekt të ligjit nr. 84/2016, trupi gjyqësor i Komisionit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me ligjin dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, duke u gjendur në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

2. Automjet tip “BMW”, me targa *, në vlerën 1.000.000 lekë**

2.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Automjet tip ‘BMW’, me targa ***. Vlera: 1.000.000 lekë*”. Si burim krijimi, subjekti deklaroi: “*Të ardhurat nga shitja e automjetit me targë *** dhe të ardhurat e akumuluar, ndër vite, nga kursimet familjare*”. Subjekti për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues.²⁰

2.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “BMW”, me targa ***, në shumën 1.000.000 lekë.

2.3. Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRr-ja Tiranë²¹, rezultoi se në emër të subjektit ka qenë i regjistruar automjeti me targa *** (***). Nga kontrolli i kryer në AMF, policat e sigurimit për këtë automjet figurojnë në emër të subjektit në periudhën 2015 – 2019.

²⁰Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.11.2016, lëshuar nga DRSHTRr-ja Vlorë, kërkesë për dokumentacion dhe të dhëna nr. *** prot., datë 25.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të dhëna mbi kërkimin, të automjetit me targa *** në pronësi të Erion Çelaj. Hyrë në qarkullim për herë të parë në datën 18.8.2014, deklarata e zhdoganimit, datë 14.8.2014, certifikata e pronësisë së automjetit tip “BMW”, me targa ***.

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 21.1.2021.

2.4. Sipas deklaratës doganore nr. ***, datë 14.8.2014 (dogana Qafë-Botë), palë importuese figuron subjekti Erion Çelaj, vendi eksportues Angli dhe vlera e detyrimeve tatimore të llogaritura për automjetin “BMW”, tipi 730D, prodhim i vitit 2007, është në shumën 384.572 lekë. Në deklaratën doganore nuk është përcaktuar vlera e automjetit dhe shpenzimet doganore janë përlllogaritur referuar çmimit të referencës në vlerën 1.922.867 lekë. Bashkëlidhur dokumentacionit të administruar ndodhet edhe certifikata e regjistrimit me të dhënat e këtij automjeti, lëshuar në Angli, në emër të shtetasit Erjon Çelaj, me adresë vendbanimi “***, Angli”. Komisioni vëren se mungon dokumentacioni ligjor justifikues për blerjen e këtij automjeti dhe vlera e paguar për të.

2.5. Në dokumentacionin e administruar nga DRSHTRR-ja, në lejen e qarkullimit rrugor dhe të dhënat lidhur me të, evidentohet historiku i lejeve dhe targave, ky automjet është regjistruar për herë të parë në datën 18.8.2014, me targa ***, ndërkohë që nga kontrolli i kryer në AMF, me të njëjtin nr. shasie: ***, rezulton polica e sigurimit e prerë për periudhën 36.7.2010 – 25.7.2011, për automjetin tip “BMW”, viti 2007, me targa ***, regjistruar në emër të shtetasit E.S. i datëlindjes 5.6.1980.

2.6. Për sa më sipër, subjektit iu kërkuan shpjegime me anë të pyetësorit nr. 1 dhe në përgjigje deklaroi se këtë automjet e ka blerë në datën 20.5.2014 nga shtetasi E.S. Adresa “****, ***, ****” është e shoqërisë së shtetasit E.S. “****” LTD, në Angli. Ky shtetas ka deklaruar adresën e punës së tij në Angli dhe ka kaluar pronësinë e automjetit në emrin e subjektit, për kryerjen e procedurave të zhdoganimit. Subjekti deklaroi se nuk ka asnjë lidhje me këtë adresë dhe se nuk ka qenë ndonjëherë në Angli. Në datën 14.8.2014 ka zhdoganuar automjetin dhe ka paguar të gjithë vlerën e detyrimit dhe taksave doganore së bashku me shërbimin e agjencisë doganore në shumën rreth 400.000 lekë. Vlera e detyrimit doganor është paguar për çmimin referencë të automjetit. Mënyra e likuidimit të vlerës së blerjes ka qenë *cash*. Çmimi i blerjes së automjetit ka qenë në shumën 600.000 lekë.

2.7. Subjekti në cilësinë e provës ka paraqitur një deklaratë të thjeshtë, datë 9.6.2021 (jo para noterit publik), lëshuar nga shtetasi E.S., i cili deklaroi se ka kryer të gjitha procedurat e nevojshme për transferimin e pronësisë në emër të blerësit Erion Çelaj dhe automjetin e ka regjistruar në Angli në emër të blerësit, në momentin e regjistrimit kërkohet adresa e blerësit dhe aty ka shënuar adresën e biznesit ku ushtron aktivitetin. Në momentin e shitjes automjeti ka qenë ende në servis dhe vlera e shitjes për të cilën kanë rënë dakord është 600.000 lekë (pa përfshirë taksat dhe detyrimet doganore) likuiduar në *cash*. Gjithashtu, deklaroi se ky automjet është djegur pjesërisht në datën 10.9.2011, disa kohë pasi e kishte sjellë në Shqipëri.

2.8. Në lidhje me faktin se automjeti ka pasur siguracioni për periudhën 26.7.2010 – 25.7.2011 dhe se zhdoganimi i automjetit është bërë në datën 14.8.2014, subjekti sqaroi se shtetasi E.S. kishte ardhur në Shqipëri me automjetin me targa ***, i cili ishte përfshirë nga flakët në pjesën e kofanos duke shkaktuar dëmtime, konfirmuar kjo edhe nga vërtetimi nr. ***, datë 27.5.2014, i lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga momenti i djegies ka qëndruar në servis deri kur subjekti e ka blerë atë. Për shkak të dëmtimeve të marra nuk mund të gjendeshin lehtë pjesë të përdorura dhe shtetasi E.S. për shkak të qëndrimit në Angli nuk i kishte kushtuar rëndësi rregullimit të shpejtë të makinës. Në këtë periudhë për shkak se subjektit duhet të udhëtonte drejt Gjermanisë për arsye shëndetësore, ka vendosur ta blejë duke u nisur nga nevoja dhe çmimi i favorshëm.

Për të provuar deklarinimet e mësipërme, subjekti paraqiti vërtetimin nr. *** prot., datë 27.5.2014, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas të cilit në datën 21.9.2011, është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale “shkatërrim i pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal. Ky procedim ka nisur mbi ngjarjen e datës 10.9.2011, ku në lagjen “****”, të qytetit të Vlorës, është konstatuar djegie me zjarr e automjetit të parkuar, tip “BMW”, me ngjyrë të zezë, me targa ***, pronë e shtetasit E.S., emigrant në Angli. Në përfundim të hetimeve nuk është njohur autori i veprës penale dhe është vendosur pezullimi i hetimeve.

2.9. Komisioni iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave²² duke i kërkuar faturën e lëshuar nga eksportuesi, e cila me shkresën nr. ***, datë 1.7.2021, informon se nuk disponon faturë blerje të automjetit të zhdoganuar.

2.10. Konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar blerjen e këtij automjeti, por ka qenë koherent në deklarinimet e bëra në DPV-në e vitit 2014, në deklaratën *Vetting*, por edhe në shpjegimet e tij gjatë hetimit, lidhur me vlerën e blerjes së mjetit në shumën 1.000.000 lekë, vlerë e cila u konsiderua në analizën financiare.

2.11. Më tej, rezulton se subjekti ka autorizuar me prokurën e posaçme nr. ***, datë 9.11.2015, kunatin e tij/personi tjetër i lidhur, z. A.I., për përdorimin (për një kohë të pacaktuar) dhe shitjen e këtij automjeti. Me kontratën nr. ***, datë 29.1.2019, automjeti i është shitur blerësit z. K.D., në vlerën 900.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Lidhur me burimin e krijimit

a) *Të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ****

2.12. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti me kontratën nr. ***, datë 20.5.2014, në shumën 900.000 lekë. Sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet palës shitëse Erjon Çelaj dhe palës blerëse I.P., automjeti tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, viti i prodhimit 2004, është shitur në vlerën 900.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

2.13. Komisioni konstaton se ky automjet është blerë me kontratën nr. ***, datë 4.8.2011, në vlerën 980.000 lekë.

2.14. Nga kontrolli i kryer në AMF, policat e sigurimit për këtë automjet figurojnë në emër të subjektit për periudhën 2011 – 2014.

b) *Kursimet familjare*

2.15. Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare në datën 14.8.2014 për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur, për blerjen e automjetit me targa ***, nga ku rezultoi një balancë pozitive në vlerën 39.030 lekë.

2.16. Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e automjetit, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve.

²²Shkresë nr. *** prot., datë 24.5.2021.

3. Depozitë në vlerën 128.023 lekë, në BKT

3.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Depozitë bankare në BKT në emër të Erion Çelaj, në vlerën 128.023 lekë, nr. llogarie ***, së bashku me shtesat nga interesat bankare në vite. Data e depozitimit të shumës fillestare 3.3.2009*”. Si burim krijimi, subjekti deklaroi: kursimet familjare. Subjekti për vërtetimin e deklaramëve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²³.

3.2. *Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar depozitë bankare në BKT, në shumën 100.000 lekë, burimi i krijimit kursime familjare.*

3.3. Referuar dokumentacionit të administruar nga BKT-ja²⁴, në emër të subjektit konfirmohet depozitë me gjendje në shumën 129.880,57 lekë (3.3.2021 – 3.3.2021), e çelur në datën 2.3.2009. Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë bankare u konstatua se kjo depozitë është krijuar me një depozitim *cash* në këtë llogari, në vlerën 100.000 lekë, në datën 2.3.2009, me përshkrim “*Erion Çelaj sa derdh në *** në ****” dhe në datën 3.3.2009 janë kaluar për krijimin e depozitës.

3.4. Komisioni konstaton se kjo depozitë është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 dhe jo në DIPP-në e vitit 2009, vit në të cilin është krijuar kjo pasuri. Më tej, Komisioni vëren se DIPP-e e vitit 2008 është dorëzuar në datën 25.3.2009, pra, pas datës së depozitimit dhe pas datës së krijimit të depozitës.

3.5. Duke qenë se në DIPP-në e vitit 2008 subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*, Komisioni analizoi tërheqjet e kryera gjatë periudhës 1.1.2009 – 2.3.2009, nga ku rezultoi një balancë negative në vlerën 92.080 lekë

3.6. *Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në shumën 100.000 lekë, pasi nga analiza financiare e datës 2.3.2009, duket se ka pasur një balancë negative në shumën 92.080 lekë.*

3.7. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: “*Në lidhje me depozitën e krijuar në datë 3.3.2009, në shumën 100.000 lekë, kam deklaruar se burimi i krijimit të saj është nga kursimet familjare. Sikurse ka konstatuar edhe Komisioni unë këtë depozitë e kam deklaruar në DIPP-në e vitit 2008. Kursimet familjare që kanë shërbyer për krijimin e kësaj depozite i përkasin vitit 2008 deri në momentin e krijimit të saj, pra, në datën 3.3.2009. Fakti i deklarimit të depozitës në vitin 2008 më ka bërë konfuz dhe më ka ngatërruar me deklarimin e gjendjes cash në këtë vit. Pasi i jam referuar që depozita në vlerën 100.000 lekë është krijuar nga gjendja cash në 2008*

²³Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.10.2016, lëshuar nga BKT-ja Gjirokastër, lëvizjet e depozitës me afat 6 muaj në emër të Erion Çelaj, çelur në shumën 100.000 lekë në datën 3.9.2009 dhe gjendje në shumën 128.023 lekë, vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga BKT-ja për llogarinë bankare të shtetasit Erion Çelaj dhe gjendjen e saj në shumën 128.023 lekë, vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016 nga BKT-ja, për shtetasin Erion Çelaj dhe të ardhurat e përfituara nga interesat gjatë periudhës 1.1.2015 – 31.12.2015, në shumën bruto 1.889 lekë, mbajtur tatim në burim shuma 283 lekë.

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 18.2.2021.

dhe kursimeve gjatë 2009. Ka qenë një pasaktësi nga ana ime mosdeklarimi i gjendjes cash në vitin 2008, por theksoj se kjo ka ardhur nga fakti i deklarimit të depozitës në vitin 2008 dhe jo në vitin përkatës të krijimit, viti 2009. Gjithashtu, Komisioni duhet të shtojë në tërheqjet e bankës edhe një tërheqje tjetër në shumën prej 10.000 lekë, e cila është tërhequr nga ana ime në datën 3.3.2009, datë valuta, por është kontabilizuar si veprim në datën 6.3.2009. Si përfundim, për shkak të ngatërimit dhe deklarimit të depozitës në DIPP e vitit 2008 nuk kam deklaruar gjendje cash dhe duke bërë jo të qartë periudhën që ka shërbyer si burim krijimi për shumën e depozitës”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.8. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore, arsyeton se:

3.9. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen e vlerës 10.000 lekë në shumën e tërheqjeve të kryera, Komisioni vlerëson se ky pretendim qëndron, pasi në dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank”, ky transaksion konstatohet të jetë kryer në datën 3.3.2009, edhe pse data e postimit është më 6.3.2009.

3.10. Lidhur me pretendimin e subjektit për mbartjen e balancës pozitive, që ka rezultuar nga analiza financiare për vitin 2008, Komisioni thekson se referuar pikës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”. Për rrjedhojë, kursimet në formën e likuiditetit cash jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet e tyre, duhet të merren parasysh duke u bazuar në deklaratat e subjektit dhe personave të lidhur, në deklaratat periodike/vjetore dhe në rastin konkret vlera prej 82.274 lekësh, e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, gjatë procesit të rivlerësimit, nuk mund të mbartet në analizën financiare të vitit 2009, për sa kohë nuk është deklaruar si kursim në kohën kur pretendohet se është krijuar.

3.11. Në këto kushte, subjekti gjendet në pamundësi financiare për shumën 82.080 lekë. Gjithsesi, Komisioni çmon që kjo mungesë e burimeve të ligjshme që ka shërbyer për krijimin e kësaj depozite, e vetme, nuk është e tillë për t’u renditur si pamjaftueshmëri që çon në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4. Gjendje cash, në vlerën 450.000 lekë

4.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “Gjendja e parave në cash, gjatë viteve në vlerë 450.000 lekë”. Si burim krijimi, subjekti deklaroi: kursimet familjare

4.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: në DIPP-në e vitit 2014, subjekti deklaroi gjendje cash në shumën 150.000 lekë; në DIPP-në e vitit 2015, subjekti deklaroi gjendje shtuar 150.000 lekë në gjendjen cash në total shuma e gjendjes cash 300.000 lekë; në DIPP-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: shtuar me 100.000 lekë gjendja e parave në cash.

4.3. Për sa rezulton, bazuar në deklaratimet në DIPP-të, në datën 31.12.2016, subjekti ka pasur likuiditete *cash* në shumën 400.000 lekë, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* ka deklaruar vlerën 450.000 lekë. Duke qenë se deklarata *Vetting* është plotësuar 26 ditë pas mbylljes së vitit, diferenca prej 50.000 lekësh duket e arsyeshme.

4.4. Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet për vitet 2014-2015-2016, paraqitur në pikën **Error! Reference source not found.** të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtyre kursimeve

4.5. Në përfundim të vlerësimit për gjendjen *cash*, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti ka kryer deklaratim të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtyre kursimeve

5. Depozitë në vlerën 3.919 USD, në emër të vajzës së subjektit S.Ç. dhe depozitë në vlerën 3.919 USD, në emër të djalit të subjektit J.Ç., në BKT

5.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaron: (i) depozitë në BKT, në emër të S.Ç., me numër llogarie ***, së bashku me shtesat nga interesat bankare në vite. Data e depozitimit të shumës fillestare më 3.3.2009, në vlerën 3.919 USD; (ii) depozitë në BKT, në emër të J.Ç., me numër llogarie ***, së bashku me shtesat nga interesat bankare në vite. Data e depozitimit të shumës fillestare më 3.3.2009, në vlerën 3.919 USD.

5.2. Si burim krijimi, subjekti deklaron: “të ardhura dhuruar fëmijëve, dërguar dorazi nga daja i tyre, A.I., për të hapur depozitë në emër të fëmijëve. Këto të ardhura janë përfituar prej tij nga puna gjatë kohës së emigracionit në Itali”. Subjekti për vërtetimin e deklaratimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²⁵.

5.3. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: (i) Në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar: depozitë bankare në BKT, në emër të tij dhe vajzës S.Ç., në vlerën 3.500 USD, me burim nga puna e kumatit të tij emigrant në Itali; depozitë bankare në BKT, në emër të tij dhe djalit J.Ç., në vlerën 3.500 USD, të dërguara nga kunati emigrant në Itali, fëmijëve të subjektit. (ii) Në DIPP-në e vitit 2012 subjekti deklaron: depozitë bankare në BKT, në emër të tij dhe vajzës S.Ç., së bashku me interesat në shumën 3.770 USD; depozitë bankare në BKT, në emër të tij dhe djalit J.Ç., së bashku me interesat në shumën 3.770 USD. (iii) Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti deklaron shtesa për secilën depozitë në shumën 7.011 lekë. (iv) Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti deklaron interesa bankare për secilën depozitë në shumën 6.767 lekë. (v) Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti deklaron interesa bankare për secilën depozitë në shumën 8.336,59 lekë.

²⁵Lëvizjet e depozitës me afat 1 vit në emër të S.Ç. dhe J.Ç., çelur më 3.3.2010, në shumën 3.500 USD dhe gjendje në shumën 3.919 USD, vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga BKT për llogarinë bankare të S. ose Erion Çelaj dhe gjendjen e saj në shumën 3.919,97 USD, vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga BKT për S.Ç. dhe të ardhurat e përfituara nga interesat gjatë periudhës 1.1.2015 – 31.12.2015, në shumën *bruto* 8.336,59 lekë, mbajtur tatim në burim shuma 1.250,49 lekë, vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga BKT për J.Ç. dhe të ardhurat e përfituara nga interesat gjatë periudhës 1.1.2015 – 31.12.2015, në shumën *bruto* 8.336,59 lekë, mbajtur tatim në burim shuma 1.250,49 lekë, deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.1.2017, nga shtetasi A.I.

²⁵Shkresë nr. *** prot., datë 18.2.2021.

5.4. Referuar dokumentacionit të administruar nga BKT-ja²⁶, konfirmohet: (i) depozitë në shumën 4.029,39 USD, në emër të subjektit dhe djalit J.Ç., me afat 1-vjeçar, me datë depozitimi të shumës fillestare më 2.3.2009; (ii) depozitë në shumën 4.029,39 USD, në emër të subjektit dhe vajzës S.Ç., me afat 1-vjeçar, me datë depozitimi të shumës fillestare më 2.3.2009.

5.5. Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë bankare u konstatua se këto depozita janë krijuar me një depozitim *cash* në vlerën 3.500 USD, në datën 2.3.2009, respektivisht në secilën llogari, me përshkrim “Erion ose S.C. *** në USD” dhe “Erion ose J.C. *** në USD”. Më tej, në datën 3.3.2009, këto shuma janë kaluar për krijimin e depozitave.

5.6. Komisioni konstaton se këto depozita janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 dhe jo në DIPP-në e vitit 2009, vit në të cilin janë krijuar. Më tej, Komisioni vëren se DIPP-në e vitit 2008 është dorëzuar në datën 25.3.2009, pra, pas datës së depozitimit dhe pas datës së krijimit të tyre.

Lidhur me burimin e krijimit

5.7. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.1.2017, lëshuar nga shtetasi A.I. i cili deklaroi se në periudhën janar - shkurt të vitit 2009, i ka dërguar nipit J. dhe mbesës S., vlerën monetare prej 6.000 euro, nga 3.000 euro/secili, shumë kjo e sjellë dorazi për t’u hapur dy depozita llogarie, nga një depozitë për secilin. Kjo vlerë monetare është siguruar prej tij nga puna në emigracion në Itali.

5.8. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 26.2.2016, subjekti është pyetur lidhur me burimin e të dhuratave të kunatit A.I. për shumën e dhuruar dy fëmijëve të tij. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se shumën e parave të dhuruara vëllai i bashkëshortes e ka sjellë dorazi, i cili ka jetuar e punuar në shtetin italian për periudhën 2004 – 2013. Këtë shumë subjekti e ka konvertuar në USD dhe e ka depozituar menjëherë në BKT, në depozitat e përbashkëta në emrin e tij dhe të fëmijëve S. dhe J., duke deklaruar çdo vit interesat bankare të shtuara.

5.9. Gjithashtu, në pyetësin standard²⁷ subjekti ka deklaruar sa më sipër u trajtua dhe se vlera monetare e shumës së dhuruar është siguruar nga puna në emigracion në Itali dhe të ardhura të tjera të realizuara prej kunatit të tij dhe familjarëve deri në atë kohë. Më tej, deklaroi se në atë kohë vjehri i tij ka qenë i sëmurë rëndë dhe ka qenë dëshira e tij që fëmijët e subjektit të kishin llogari kursimi të hapur për shkak dhe të merakut që kishte për problemet shëndetësore të djalit. Kjo llogari nuk është prekur prej subjektit dhe do të vazhdojë të mbetet e tillë.

Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti në cilësinë e provës dorëzoi dokumentin “deklaratë page”, datë 10.1.2017, të lëshuar nga shoqëria “****”, sipas të cilës z. A.I. ka punuar pranë kësaj shoqërie duke filluar nga data 1.3.2007 – 15.10. 2011, më pagë 1.580 euro/muaj.

5.10. Komisioni vëren se dokumenti i mësipërm nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, nuk është i noterizuar dhe përkthyer para noterit publik dhe nuk mban vulë apostile.

Sa rezulton, ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për burimin e të ardhurave të personit tjetër të lidhur/A.I., për dhurimin e shumës 6.000 euro në favor të fëmijëve të subjektit.

²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 18.2.2021.

²⁷E-mail datë 2.2.2021, ora 16:31.

5.11. Në kuptim të pika 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, z. A.I., konsiderohet për efekt të këtij ligji person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak të dhurimit të shumë 6.000 euro dhe, për rrjedhojë, ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në përputhje pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

5.12. Për sa rezulton, Komisioni i kërkoi informacion subjektit me anë të pyetësorit nr. 1.

Në përgjigje, subjekti deklaroi se kunati i tij, z. A.I., gjatë qëndrimit në Itali si emigrant ekonomik ka punuar pranë shoqërisë “****”, për periudhën mars 2007 – tetor 2011, me pagë *neto* 1.580 euro/muaj dhe nuk ka pasur dokumente të rregullta qëndrimi në shtetin italian dhe si rezultat nuk ka pasur mundësi të deklarohej në INPS për punën e kryer. Të ardhurat e realizuara nga puna, herë pas here, i ka dërguar në Shqipëri me persona të njohur. Subjekti në cilësinë e provës paraqiti përsëri dokumentin “deklaratë page”, datë 10.1.2017²⁸.

5.13. Sa më lart, duket se nuk përmbushen kërkesat e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, që parashikojnë se subjekti duhet të shpjegojë bindshëm jo vetëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, por edhe ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat duhet të jenë të krijuara nga burime të ligjshme, të jenë të deklaruara dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse.

5.14. Më tej, nga verifikimi në sistemin *TIMS*, rezulton se shtetasi A.I. ka dalë për herë të parë nga territori shqiptar në datën 15.9.2011.

5.15. Nga të dhënat e regjistrit të gjendjes civile, aksesuar nga Komisioni, në nëntor të vitit 2008 rezulton se në përbërjen familjare të të ndjerit Sh.I. figuron shtetasi E.I., i cili ka të njëjtin mbiemër, atësi, mëmësi dhe datëlindje si shtetasi A.I. Nga verifikimi në sistemin *TIMS* rezulton se shtetasi E.I. ka dalë nga territori shqiptar në datën 22.1.2008 nga pika kufitare Kakavijë dhe nuk ka asnjë të dhënë tjetër për hyrje apo dalje të tjera.

5.16. Komisioni konstaton se, në të dy rastet, daljet e para nga territori shqiptar janë kryer pas datës 1.3.2007, datë e cila figuron si data e fillimit të punësimit në Itali, referuar vërtetimit të paraqitur nga subjekti.

5.17. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *mungon dokumentacioni ligjor justifikues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur/A.I., për dhurimin e shumë 6.000 euro dhe, për rrjedhojë, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitave bankare me vlerë fillestare 7.000 USD.*

5.18. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: *“Kunati im A.I. ka qëndruar për një kohë të gjatë në shtetin Italian. Nga sa jam vënë në dijeni prej tij daljet nga shteti Shqiptarë i ka pasur të parregullta. Gjatë kësaj periudhe ka dalë në mënyrë klandestine nga vendi për shkak të arsyeve*

²⁸Subjekti paraqiti në cilësinë e provës paraqiti përsëri dokumentin “deklaratë page”, datë 10.1.2017, të lëshuar nga shoqëria “****”, përkthyer dhe njësuar me origjinalin nga gjuha italiane në atë shqipe, sipas të cilës z. A.I. ka punuar pranë kësaj shoqërie duke filluar nga 1.3.2007 – 15.9.2011, me pagë 1.580 euro/muaj.

ekonomike. Punësimi i tij në Itali ka qenë gjithmonë në të zezë, pasi nuk ka arritur të bëjë dokumentet dhe të punësohet në mënyrë të rregullt. Konstatimi i Komisionit se nga verifikimi në sistemin TIMS rezultojnë hyrje dhe dalje nga territori shqiptar në datë të mëvonshme dhe që nuk përkojnë me kohën e punësimit të tij në Itali, vjen për shkakun e kalimit klandestin të kufirit për arsye ekonomike. Gjatë periudhës që ai ka qenë i punësuar në Itali nuk figuron të jetë i punësuar në Shqipëri. Vetëm pasi është kthyer nga Italia ka filluar marrëdhëniet pune në mënyrë të rregullt. Sikurse e kam deklaruar edhe në pyetësonin standard, gjatë vitit 2010 unë bashkë me familjen kemi qëndruar për disa ditë në apartamentin ku kunati jetonte me adresë ‘***’. Komisioni në rastin konkret duhet të vlerësojë se subjekti është në kushtet e parashikuara nga pika 2, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ku mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Të ardhurat e krijuara në emigracion pas viteve 90, janë një realitet që nuk mund të mohohet nga Komisioni”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.1. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

5.19. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin dhe nuk provoi të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/A.I., vëllai i bashkëshortes së subjektit.

5.20. Në lidhje me pretendimin e subjektit se për të provuar këto të ardhura ndodhet në kushtet e parashikuara nga pika 2, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ku mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme, trupi gjykues vlerëson se nuk është relevant për zgjidhjen e çështjes, pasi edhe sikur të kishte kërkuar dokumentacion në Itali për punën e kryer nga personi tjetër i lidhur, nuk do të mund të provohej shuma e pretenduar prej tij si e ardhur.

5.21. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion se personi tjetër i lidhur ka punuar në Itali dhe ka realizuar të ardhura nga puna e tij, për pasojë, të ardhurat e pretenduara që kanë shërbyer për krijimin e këtyre dy llogarive, nuk do të konsiderohen në analizën financiare si burime të ligjshme sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

5.22. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për krijimin e depozitave bankare në vlerën 7.838 USD, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

6. Apartament me qira, në vlerën 10.000 lekë/muaj, në Vlorë

6.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Apartament i marrë me qira, ku banoj me familjen time me sip. 96 m² të ndodhur në lagjen ‘***’, rruga ‘***’, Vlorë, në katin e parë të një godine *** kate, pronë e shtetasit V.A. Kjo sipas marrëveshjes gjore me të për periudhën 1-vjeçare, përkundrejt likuidimit në dorë të qirasë në shumën*

10.000 lekë/muaj. Vlera 120.000 lekë”. Subjekti për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues.²⁹

6.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DIPP-në e vitit 2008 dhe aktualisht, subjekti deklaron se banon në adresës; lagja “****”, pas gjimnazit “****”, Vlorë , lagja “****”, rruga “****”, Vlorë, por nuk deklaron shpenzime qiraje.

6.3. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. ***, datë 17.3.2016, të lëshuar nga shtetasi V.A., i cili deklaron se prej vitit 2009 dhe deri në momentin e plotësimit të deklaratës i ka dhënë me qira subjektit Erion Çelaj, një apartament 2+1, me sip. 96 m², që ndodhet në lagjen “****”, rruga “****”, në vlerën qirasë 10.000 lekë/muaj.

6.4. Në pyetësonin standard³⁰, subjekti deklaron se prej datës 1.4.2008 dhe aktualisht banon në adresën: lagja “****”, rruga “****”, banesa private nr. ***, në apartamentin që ndodhet në katin e *** të një godine ***-katëshe në pronësi të shtetasit V.A. Vlera e qirasë është 10.000 lekë/muaj.

6.5. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datën 26.2.2016, subjekti deklaron se banon në adresën e mësipërme me qira 10.000 lekë/muaj, shtëpia është e mobiluar tërësisht nga pronari i saj. Për secilin kat të banesës ka matës për konsumin e energjisë dhe shpenzimet e energjisë elektrike në muaj janë rreth 5,000 lekë, të cilat dhe së bashku me qiranë subjekti ia jep pronarit. Deklaron se nuk disponon kontratë qiraje, për shkak të lidhjes miqësore që ka me pronarin, por dhe të vlerës së ulët të qirasë.

6.6. Nga hetimi i Komisionit³¹, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë³², nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit, në kushtet e konfliktit të interesit me qiradhënësin e këtij apartamenti.

6.7. Më anë të pyetësonit nr. 1, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor provues lidhur me pronësinë e këtij apartamentit. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti certifikatën për vërtetim pronësie lëshuar në datën 5.5.2006, në emër të pronarit shtetasit V.A.

6.8. Komisioni vëren se referuar certifikatës së pronësisë nr. ***, datë 9.3.2006, në emër të shtetasit V.A. figuron pasuria me nr. ***, vol. ***, e llojit ndërtesë me sip. 104 m², me adresë: lagja “****” Vlorë. Sipas kartelës së pasurisë, pasuria e llojit ndërtesë me *** kate (me shënimin leje ndërtimit) është regjistruar në emër të shtetasit V.A. në datën 5.5.2006.

Lidhur me adresat e tjera të banimit

6.9. Subjekti deklaron se është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër në datën 3.10.1998. Gjatë kësaj periudhe deri në datën 6.12.2000, ka banuar në apartamentin me adresë: lagja “****”, Kodra e Shtufit, ap. ***, shk. ***, kati i ***-të, Gjirokastër, pronë e prindërve të tij, përfituar sipas autorizimit të Entit Kombëtar të Banesave.

²⁹Deklaratë noteriale nr. ***, datë 17.3.2016, lëshuar nga shtetasi V.A.

³⁰E-mail datë 2.2.2021, ora 16:31.

³¹Shkresë nr. *** prot., datë 8.6.2021.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 17.6.2021.

6.10. Nga 7.12.2000 – 29.2.2004, është emëruar Prokuror i Rrethit Gjyqësor Përmet. Gjatë kësaj periudhe ka qëndruar në adresën: lagja “****”, kati i ***, ish-Ndërmarrja e Përpunim Drurit, z. k. ***, me qira në vlerën 2.500 lekë/muaj.

6.11. Më pas, është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier nga 1.3.2004 – 23.4.2007. Gjatë kësaj periudhe ka qëndruar në ambientet e Hotel *** me vlerë qiraje 3.000 lekë/muaj dhe ndonjëherë udhëtonte edhe në Kuçovë te prindërit e bashkëshortes.

6.12. Për periudhën 1.5.2007 – 31.3.2008, ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, gjatë kësaj periudhe ka qëndruar në Gjirokastër në apartamentin e prindërve me adresë: lagja “****”, Kodra e Shtufit, ap. ***, shk. ***, kati i ***-të, Gjirokastër. Rrugën e ka bërë ose me automjete të rastit ose me të njohur bashkëqytetar që udhëtonin nga Gjirokastra në Sarandë.

6.13. Në përfundim të hetimit të këtij deklarami, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin përdorimin e kësaj pasurie.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT/L.Ç.

7. Gjendje cash në vlerën 320.900 lekë

7.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deklaroi: “*Gjendje cash të përfutur në vitin 2016, në vlerën 320.900 lekë*”.

7.2. Si burim krijimi, subjekti deklaroi: “... nga shitja e 1/6 pjesë të një apartamenti banimi, me sip. 36 m², trashëgimi e prindërve, ndodhur në lagjen ‘***’, Kuçovë”. Subjekti, për vërtetimin e deklaramëve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues³³.

7.3. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në deklaratën *Vetting* subjekti ka dorëzuar kontratën nr. ***, datë 29.8.2016, nënshkruar ndërmjet palës shitëse T.I., L.Ç., A.I. dhe palës blerëse L.B., për shitjen e pasurisë nr. ***, me sip. 36 m², nga e cila 14.04 m² truall dhe 36 m² ndërtesë, ndodhur në Kuçovë, kundrejt shumës 2.000.000 lekë. Për këtë pasuri është bërë rivlerësimi në datën 21.10.2013, në vlerën 2.700.000 lekë. Likuidimi është kryer me mandatdepozitim *cash* të shumës 2.000.000 lekë, në datën 29.8.2016, në llogarinë e noteres A.B. - person fizik në BKT, nga shtetasi L.B., me përshkrim veprimi “derdhje për shitblerje pasurie në emër të noteres A.B., pala shitëse T.I., L.Ç., A.I. dhe palës blerëse L.B.”.

7.4. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, datë 5.11.2013, ky apartament ka qenë i regjistruar në emër të shtetasve T.I. (4/6 pjesë), L.Ç. (1/6 pjesë) dhe A.I. (1/6 pjesë).

7.5. Për të provuar kalimin e vlerës takuese në favor të bashkëshortes, subjekti ka paraqitur lëvizjet e llogarisë së pagës në emër të shtetasës L.Ç. në Bankën Kombëtare Tregtare gjatë harkut kohor 1.9.2016 - 28.10.2016, ku evidentohet kreditimi i llogarisë në datën 13.9.2016, në shumën 333.333 lekë nga notere A.B., sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***. Në datën 23.9.2016, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr *cash* nga llogaria shumën prej 320.900 lekësh.

³³Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 29.8.2016, mandatdepozitimi *cash* i shumës 2.000.000 lekë, datë 29.8.2016, certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 5.11.2013, harta treguese dhe kartela e pasurisë së paluajtshme, lëvizjet e llogarisë së pagës në emër të znj. L.Ç., pranë BKT-së, gjatë harkut kohor 1.9.2016 - 28.10.2016.

7.6. Në përfundim të vlerësimit për gjendjen *cash* të disponuar nga personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtyre kursimeve.

KONSTATIME TË TJERA PËR KONTROLLIN E PASURISË

8. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa *, në vlerën 500.000 lekë**

8.1. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar automjetin tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1995, me targa ***, blerë nga shtetasi B.B., në vlerën 500.000 lekë.

8.2. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të paraqesë kontratën e blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, si dhe burimin e krijimit për blerjen e tij. Në përgjigje, subjekti paraqiti kontratën nr. ***, datë 9.11.2004, me palë shitëse shtetasi B.B. dhe palë blerëse subjekti Erion Çelaj, ku çmimi paraqitet në shumën 500.000 lekë. Si burim krijimi subjekti deklaroi se kanë shërbyer të ardhurat nga kursimet nga pagat në vitin 2004, gjendja e mbetur nga viti 2003, si dhe shuma e të hollave të dhuruara nga të afërm dhe miq (rreth 25.000 lekë) me rastin e 1-vjetorit të vajzës, më 30.6.2004.

8.3. Duke qenë se në kontratë citohet se targa është e huaj, me anë të pyetësorit nr. 2³⁴, subjektit iu kërkua të japë shpjegime se kush i ka kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti dhe, në përgjigje, subjekti shpjegoi se zhdoganimi ka qenë pjesë e dokumentacionit në momentin që e ka blerë këtë automjet dhe se të gjitha procedurat e zhdoganimit janë kryer nga pala shitëse.

8.4. Për të provuar këtë deklaram, Komisioni kërkoi informacion³⁵ lidhur me zhdoganimin e këtij automjeti dhe referuar dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja³⁶ rezultoi se procedurat janë kryer nga shtetasi B.B.: deklarata doganore mban datën 22.10.2004, automjeti është në vlerën (3.900 euro * 124.80) 486.720 lekë dhe shpenzimet doganore në vlerën 256.954 lekë, në total 743.674 lekë.

Sa rezulton, shtetasi B.B. e ka blerë këtë automjet në vlerë më të lartë se ajo e shitjes, në shumën 500.000 lekë, pas 20 ditësh nga data e zhdoganimit.

8.5. Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar likuiditete *cash* në fund të vitit 2003 dhe, për rrjedhojë, Komisioni kreu analizën financiare për harkun kohor 1.1.2004 - 9.11.2004 për të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur (subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë disponuar likuiditete në llogaritë bankare në vitin 2004), nga ku rezultoi një balancë pozitive në vlerën 90.535 lekë.

8.6. Në analizë të sa më sipër, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit me targa ***.

8.7. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me konstatimin se: *Ka dyshime për trajtim preferencial të subjektit, pasi, rezulton se ky*

³⁴E-mail datë 24.6.2021.

³⁵Shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2021.

³⁶Shkresë nr. *** prot., datë 9.7.2021.

automjet është blerë nga ana e shtetasit B.B. në vlerën (3.900 euro * 124.80) 486.720 lekë dhe shpenzimet doganore në vlerën 256.954 lekë, në total 743.674 lekë. Ndërkohë që vetëm 20 ditë nga data e zhdoganimit i është shitur subjektit në shumën 500.000 lekë, me kontratën nr. ***.

8.8. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të konstatimit të Komisionit, deklaroi se: “Komisioni ka konstatuar dyshim për trajtim preferencial, pasi vlera e automjetit të importuar nga shtetasi B.B. në total 743.674 lekë është më e ulët se vlera që ma ka shitur këtë automjet në shumën 500.000 lekë. Për sa është konstatuar, unë këtë automjet e kam blerë 50.000 lekë më pak se çmimi që vetë shitësi e mbante. Ky shtetas jetonte jashtë gjatë kësaj periudhe dhe ka sjellë disa herë automjete për t’i shitur ato në Shqipëri. Nuk kam pasur informacion sa ka qenë çmimi i blerjes dhe kostoja totale për këtë automjet, kam negociuar për të më ulur vetëm 50.000 lekë nga çmimi që ai mbante”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

8.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore, arsyeton se:

8.10. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm trajtimin preferencial që kishte pasur për blerjen e këtij automjeti. Komisioni vlerëson se për vetë faktin se shitësi jetonte jashtë dhe kishte sjellë disa here automjete për t’i shitur, nuk ka pasur arsye për t’ia shitur më lirë, duke mos marrë mbrapsht as kostot e shpenzuara për blerjen dhe transportin e këtij automjeti.

9. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa *, në vlerën 6.500 euro**

9.1. Nga hetimi i Komisionit rezulton se në datën 11.6.2007, me anë të kontratës nr. ***, subjekti ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz E220 CDI”, viti i prodhimit 2000, në vlerën 6.500 euro.

9.2. Konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 blerjen e këtij automjeti, me targa ***, në kundërshtim me germën “b”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ku parashikohet deklarimi i pasurive të luajtshme dhe të drejtat reale mbi to.

9.3. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 26.2.2016, subjekti është pyetur lidhur me automjetet që ka zotëruar në vitet 2004 – 2014 dhe, në përgjigje, sqaron se në vitin 2004 ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz 250”, viti i prodhimit 1995, të cilin e ka mbajtur rreth 3 vjet dhe pas shitjes ka blerë automjetin tjetër me targa ***, prodhim i viti 2000. Duke qenë se vlera e shitjes së automjetit të mëparshëm dhe e blerjes së këtij automjeti ka qenë e njëjtë, është neglizhuar nga ana e tij, pasi momenti kur ka bërë deklaratimin përkon me periudhën kur është transferuar nga Fieri në Sarandë. Subjekti, më tej, shpjegon se ka deklaruar me saktësi si targetat dhe datat e kontratave të shitblerjes, pra nuk ka pasur arsye të fshehtë apo të mos deklarojë.

9.4. Sa më sipër rezulton, Komisioni vëren se nuk qëndron deklarimi i subjektit se vlera e shitjes së automjetit me targa *** dhe e blerjes së automjetit me targa *** ka qenë e njëjtë, pasi respektivisht janë shitur dhe blerë në shumat 200.000 lekë dhe 6.500 euro.

9.5. Subjekti, me pyetësin nr. 2³⁷, u pyet lidhur me burimin e krijimit të automjetit me targa ***. Në përgjigje, subjekti deklaroi se një prej burimeve është shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz E 250”, me targa ***, sipas kontratës nr. ***, datë 5.5.2007. Subjekti shpjegon se në këtë kontratë ka një gabim material në përcaktimin e vlerës së shitjes së automjetit, pasi çmimi nuk ka qenë 200.000 lekë, por 500.000 lekë. Këtë fakt, vijon subjekti, e ka sqaruar edhe në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, ku ka shpjeguar se vlera e shitjes së automjetit me targa *** ka qenë sa vlera e blerjes. Në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nuk i ka dhënë rëndësi vlerës, pasi ishte dakordësuar për shumën e të hollave të marra nga shitja e automjetit. Këto veprime dhe pakujdesi të treguara janë si rezultat i kohës kur janë kryer. Gjithashtu, si burim tjetër krijimi, përfundon subjekti, ka shërbyer edhe mundësia e kursimit deri në datën e blerjes së automjetit.

9.6. Komisioni vlerëson se kontrata është veprim juridik me anë të së cilës palët shprehin vullnetin e tyre, prandaj kontrata e shitjes së automjetit prevalon mbi deklaratimet e subjektit. Në këto kushte, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, do të konsiderohet dokument shkresor, sipas formës së parashikuar në ligj, kontrata e shitjes nr. ***, datë 5.5.2007, në vlerën 200.000 lekë dhe jo deklaratimet e subjektit, i cili pretendon si vlerë shitjeje shumën 500.000 lekë.

9.7. Për më tepër, konstatohet se subjekti nuk e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, viti i prodhimit 1995, me kontratën nr. ***, datë 5.5.2007, në shumën 200.000 lekë.

9.8. Për të verifikuar burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit në shumën 6.500 euro, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet për harkun kohor 1.1.2007 – 11.6.2007, nga ku rezultoi një balancë negative në vlerën 258.428 lekë.

9.9. Ky automjet është shitur me kontratën nr. ***, datë 30.4.2010, në shumën 990.000 lekë.

9.10. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *(i) subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit, pasi nga analiza financiare e datës 11.6.2007 duket se ka pasur një balancë negative në shumën 258.428 lekë; (ii) subjekti nuk ka deklaruar shitjen dhe blerjen e automjeteve të mësipërme në deklaratat periodike vjetore, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga germa “b”, e pikës 1, të neni 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ku parashikohet deklarimi i pasurive të luajtshme dhe të drejtat reale mbi to.*

9.11. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore, në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: *“Në lidhje me blerjen e automjetit tip*

³⁷E-mail datë 24.6.2021.

*'Mercedes-Benz E 220 CDI', në vlerën 6.500 euro sqaroj Komisionin se në DIPP-në e vitit 2007 nuk kam deklaruar blerjen e këtij automjeti për shkak të harresës dhe pakujdesisë në plotësimin e deklaratës. Në vitin 2007 ka ardhur në jetë djali J. dhe në momentin e plotësimit të deklaratës në vitin 2008 kemi qenë vërtet të shqetësuar për shëndetin e tij si rezultat i problemeve që kishte shfaqur. Gjithashtu, në këtë periudhë jam transferuar si prokuror nga Fieri në Sarandë. Për këto arsye nuk i kam dhënë rëndësinë e duhur plotësimit të deklaratës vjetore. Blerja dhe shitja e automjetit kanë qenë veprime juridike të deklaruara në mënyrë të rregullt nga ana ime dhe përveç fakteve të shpjeguara më lart nuk ka pasur asnjë qëllim tjetër për t'i fshehur ato. Kontrata noteriale të cilat janë lehtësisht të aksesueshme në regjistrat e mbajtjes së automjeteve. Madje në këtë deklaratë unë nuk kam deklaruar gjithashtu edhe shitjen e automjetit, blerë në vitin 2004. Nëse do ta kisha deklaruar shitjen e këtij automjeti në vitin 2007 do ta kisha konstatuar menjëherë që vlera e shitjes sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 5.5.2007, nuk ishte e njëjtë me vlerën e shitur realisht. Edhe gjatë shpjegimeve në ILDKPKI, në datën 26.2.2016, kam qenë i bindur që vlera e shitjes së automjetit ka qenë pothuajse e njëjtë me atë të blerjes. Kujtoj që kisha shtuar një shumë të hollash për blerjen e automjetit. Kërkoj nga Komisioni që pavarësisht se në kontratë çmimi është përcaktuar 200.000 lekë të merret në analizë çmimi real i shitjes, ai në shumën 500.000 lekë. Sikurse është deklaruar prej meje gjatë pyetësorëve përpara se të konstatohej diferencë negative për mosmbulimin e vlerës së blerjes. Në momentin që nga Komisioni më është kërkuar burimi i krijimit për blerjen e automjetit në shumën 6.500 euro kam konstatuar se në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 5.5.2007, çmimi në kontratë nuk ishte 500.000 lekë sikurse realisht e kam shitur, por 200.000 lekë. Nëse në analizën financiare vlera e shitjes së automjetit do të merrej vlera reale e shitjes 500.000 lekë dhe jo vlera e deklaruar në kontratë për shkak të gabimit material që përmban, atëherë do të rezultoj që kam burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për blerjen e automjetit në shumën 6.500 euro”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

9.12. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

9.13. Në lidhje me pretendimin e subjektit se deklarimi i pasaktë në deklaratimet e mëparshme periodike të interesave nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se qëndron ky pretendim për aspektin deklarativ, por jo për efekt të analizës financiare ku subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në datën e kontratës së shitblerjes.

9.14. Pretendimi i subjektit për të konsideruar vlerën 500.000 lekë si të ardhur nga shitja e automjetit me targa *** nuk qëndron, për sa kohë që kontrata e shitjes nr. ***, datë 5.5.2007, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shitësit të automjetit shtetasit K.S., ku figuron çmimi i shitjes prej 200.000 lekësh, ka formën e kërkuar nga ligji dhe nuk është goditur për

pavlefshmëri, për sa kohë nuk u provua që kjo kontratë të ishte revokuar apo kundërshtuar nga asnjëra prej palëve, efekte të cilat nuk mund të zhbëhen me deklaramë të mëpasshme.

9.15. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi mungesën financiare nga burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në datën 11.6.2007.

9.16. Në këto kushte mbetet konstatimi fillestar se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit, pasi nga analiza financiare e datës 11.6.2007 kanë rezultuar me balancë negative në shumën 258.428 lekë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

10. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa *, në vlerën 980.000 lekë**

10.1. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, me kontratën nr. ***, datë 4.8.2011, në vlerën 980.000 lekë.

10.2. Sipas dokumentacionit të administruar nga ILDKPKI-ja³⁸, subjekti ka paraqitur prokurën e posaçme nr. ***, datë 15.9.2010, lëshuar nga shtetasi T.T., sipas së cilës ky i fundit ka emëruar dhe autorizuar subjektin si përfaqësues të posaçëm për administrimin dhe huapërdorjen pa afat të automjetit tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, deri në regjistrimin përfundimtar të tij dhe kryerjen e veprimeve doganore. Ky shtetas deklaroi se automjetin ia ka shitur subjektit kundrejt vlerës 980.000 lekë dhe ky i fundit nuk ka detyrime financiare ndaj shitësit.

10.3. Sa më lart, Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 blerjen e automjetit me targa ***, në vlerën 980.000 lekë, në kundërshtim me germën “b”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ku parashikohet deklarimi i pasurive të luajtshme dhe të drejtat reale mbi to.

10.4. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjekti u pyet lidhur me burimin e krijimit për blerjen e këtij automjeti dhe, në përgjigje, subjekti paraqiti kontratën e shitjes së automjetit nr. ***, datë 4.8.2011, duke sqaruar se pavarësisht se kontrata mban datën 4.8.2011, këtë automjet ka filluar ta përdorë në momentin që shtetasi T.T. e ka pajisur me prokurë të posaçme për të ndjekur të gjitha procedurat ligjore për kalimin e pronësisë së automjetit. Në prokurë shtetasi T.T. ka deklaruar se automjetin ia ka shitur subjektit kundrejt vlerës 980.000 lekë dhe se subjekti nuk ka detyrime për vlerën e këtij automjeti. Momenti i pagesës është pikërisht data e nënshkrimit të prokurës së posaçme, pra, 15.9.2010 dhe si burim krijimi për pagesën e kryer në shumën 980.000 lekë kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit sipas kontratës nr. ***, datë 30.4.2010.

10.5. Me pyetësorin nr. 2, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me faktin se kush i ka kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti. Në përgjigje, subjekti deklaroi se të gjitha procedurat e zhdoganimit dhe pagesat janë kryer prej tij dhe se e ka blerë këtë automjet pa

³⁸Shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2021.

doganë dhe vlera e blerjes është 980.000 lekë, ndërkohë si kosto duhet t'i shtohet edhe vlera e paguar për doganën.

Sa më sipër, Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar saktë në DPV-në e vitit 2011 shumën totale të shpenzimeve për këtë automjet (çmimi i blerjes plus shpenzimet doganore), bazuar në germën "h", të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

10.6. DPSHTRR-ja³⁹ përcolli deklaratën doganore nr. ***, datë 21.7.2011, ku paraqitet si eksportues shtetasi T.T. dhe si marrës importues individual automjetesh i detajuar po shtetasi T.T. Vlera e automjetit paraqitet në shumën 1.029.392 lekë⁴⁰ dhe detyrimet doganore në vlerën 297.680 lekë.

10.7. Komisioni konstaton se vlera e paraqitur në deklaratën doganore është më e lartë se vlera me të cilën e ka blerë subjekti dhe se ky automjet është zhdoganuar 10 muaj pasi subjekti ka kryer pagesën ndaj shitësit dhe ka poseduar automjetin.

Lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***

10.8. Komisioni konstaton se të ardhurat nga shitja e automjetit me targa *** (trajtuar në pikën 8 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht) kanë qenë në shumën 990.000 lekë, pra 182.765 lekë më shumë sesa është blerë.

10.9. Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁴¹ nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti (diferenca prej 182.765 lekësh mes çmimit të shitjes dhe atij të blerjes) dhe, për këtë arsye, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar.

Lidhur me pagesën e detyrimeve doganore

10.10. Komisioni kreu analizën financiare në datën 21.7.2011 për të verifikuar nëse subjekti ka pasur burime të ligjshme për pagesën e detyrimeve doganore në vlerën 297.680 lekë, ku rezultoi balancë pozitive në vlerën 155.041 lekë.

10.11. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e detyrimeve tatimore për fitimin e realizuar nga shitja e automjetit me targa *** dhe, për rrjedhojë, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 182.765 lekë për blerjen e automjetit me targa ***;* (ii) *subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 blerjen e automjetit me targa ***, në vlerën 980.000 lekë, në kundërshtim me germën "b", të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ku parashikohet deklarimi i pasurive të luajtshme dhe të drejtat reale mbi to;* (iii) *subjekti nuk ka deklaruar saktë në DPV-në e vitit 2011 shumën totale të shpenzimeve për këtë automjet (çmimi i blerjes plus shpenzimet doganore), bazuar në germën*

³⁹Shkresë nr. *** prot., datë 9.7.2021.

⁴⁰Vlera 7.280 euro e vlerësuar me kursin e deklaratës doganore 141.41 lekë.

⁴¹Shkresë nr. *** prot., datë 27.1.2021.

“h”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003; (iv) vlera e paraqitur në deklaratën doganore është më e lartë se vlera me të cilën subjekti e ka blerë këtë automjet (zhdoganuar 10 muaj pasi ka kryer pagesën dhe ka poseduar automjetin).

10.12. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: “Në lidhje me blerjen e automjetit me targa ***, sikurse edhe e kam deklaruar në ILDKPKI shtetasi T.T. më ka lënë prokurë të posaçme nr. ***, datë 15.9.2010, pasi unë i kisha paguar vlerën e blerjes prej 980.000 lekësh të automjetit. Komisioni ka konstatuar se në DIPP-në e vitit 2010 unë nuk kam deklaruar të drejtën reale sipas përcaktimeve ligjore në nenin 4, pika 1, germa ‘b’, e ligjit nr. 9049. Sqaroj Komisionin se nga momenti i marrjes së prokurës së posaçme kam dashur gjithmonë të vazhdoja procedurat e zhdoganimit dhe të targimit të automjetit. Kisha pyetur se vlera e zhdoganimit për këtë automjet do më kushtonte rreth 300.000 lekë dhe sapo të kisha mjaftueshëm gjendje likuiditeti do të shkoja të paguaja.

10.13. Mosdeklarimi i të drejtës reale në vitin 2010 ka qenë një ngatërresë nga ana ime. Mendoja që do të kryeja procedurat e zhdoganimit dhe të deklaroja kontratën e shitblerjes për këtë automjet. Nuk kam pasur asnjë qëllim për të mos deklaruar këtë të drejtë për sa kohë kisha prokurë të posaçme dhe kisha kryer pagesën për blerjen e automjetit. Prokura e posaçme do të ishte pjesë e kontratës së shitblerjes dhe pjesë e dosjes së automjetit duke e deklaruar këtë dokument në çdo instancë shtetërore.

10.14. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se kam pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 182.765 lekë për blerjen e automjetit me targa *** vlerësoj se nuk qëndron, pasi Komisioni për vitin 2010 nuk ka kryer analizë financiare. Nëse do të kryenim analizë financiare nga data 1.1.2010 deri më 15.9.2010, që është data e pagesës së shumës prej 980,000 lekësh shtetasit T.T. do të rezultojë që kam pasur të ardhura të ligjshme për të kryer pagesën prej 980,000 lekësh, pavarësisht shumës nga fitimi i realizuar nga shitja e automjetit me targa ***.

10.15. Komisioni duhet të konsiderojë si të ardhur të ligjshme fitimin në vlerën lekë të realizuar nga shitja e automjetit. Fitimi nga shitja e automjetit nuk mund të trajtohet referuar germës ‘g’ të nenit 8 ‘Të ardhurat e tatueshme’ për sa kohë një gjë e tillë nuk është përcaktuar në mënyrë eksplicite në ligj.

10.16. Në nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet se: ‘Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj’. Pra, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton mjaft qartë se taksat dhe tatimet vendosen vetëm me ligj dhe asnjë organ shtetëror apo publik nuk mund të përcaktojë se cilat janë të ardhurat e tatueshme. Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’ nuk parashikohet se fitimi i realizuar nga individët nga shitja e automjeteve është një e ardhur e tatueshme. Në këtë kuadër, nuk është e drejtë që Komisioni ta kategorizojë këtë të ardhur si të ardhur të tatueshme. Fitimi i realizuar nga shitja e automjeteve nga individët (pra, jo si veprimtari tregtare) nuk rezulton të jetë parashikuar si e ardhur e tatueshme në asnjë ligj në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

10.17. *Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 12/2028 ndaj subjektit të rivlerësimit B. D., në të cilin arsyeton se: ‘... Kushtetuta nuk e ka lënë në diskrecion të organeve ligjzbatuese përcaktimin e të ardhurave ‘të tatueshme’, por ia ka njohur vetëm ligjit. Për këtë arsye, pjesa e shkëputur e fjalisë ‘të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e parashikuara në këtë nen’ mund të gjejë zbatim vetëm brenda një norme pozitive ligjore, jo akti nënligjor dhe as diskrecional të organeve publike ...’. Në këto kushte, konkluzioni i arritur nga Komisioni për këtë automjet nuk qëndron.*

10.18. *Germa ‘d’ e nenit 13 trajton fitimin kapital neto të krijuar nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme dhe jo fitimin e krijuar nga pasuritë e luajtshme. Ndonëse për pasuritë e paluajtshme ka një çmim dysHEME, për efekt të përlllogaritjes së vlerës së shitjes dhe vlerës së pagesës së tatimit, kjo nuk ndodh me pasuritë e luajtshme. Ligjvënësi nuk ka parashikuar raste kur një individ nuk rezulton me fitim, por me humbje nga shitja e një automjeti. Në këto raste, humbja nuk konsiderohet si shpenzim i njohur për efekt të përlllogaritjes së detyrimit tatimor, referuar nenit 13/3 të ligjit. Nëse me termin ‘të ardhura të tjera’ do të kuptohej çdo e ardhur, atëherë nuk kishte pse në ligj të specifikohet lloji i të ardhurave të tatueshme.*

10.19. *Përveç sa më sipër, në kuptim të ligjit nr.8438 ‘Për tatimin mbi të ardhurat personale’ neni 13 ‘Deklarata individuale vjetore e të ardhurave’, përjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2.000.000 lekë. Për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme nuk paraqitet vlera e të ardhurave, por fitimi kapital i realizuar nga shitja e pasurive. Në këtë kuptim, subjekti nuk ka pasur detyrimin për të plotësuar deklaratën dhe në të njëjtën kohë nuk kam pasur detyrimin për të paguar tatimin për fitimin e realizuar nga shitja e automjetit”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.20. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

10.21. Në lidhje me pretendimin e subjektit për të konsideruar në analizën financiare të ardhurat nga shitja e automjetit, pasi nuk mund të kategorizohet si e ardhur e tatueshme, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka realizuar fitim nga shitja e këtij automjeti edhe në vlerësim të parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton se: “Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”.

10.22. Nën dritën e sa më sipër, të ardhurat e realizuara nga shitja me fitim të pasurive të luajtshme nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj. Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit) nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë,

vlera e fitimit të realizuar rezulton të jetë e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

10.23. Lidhur me pretendimin e subjektit se referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13, “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave”, përjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura *bruto* vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2.000.000 lekë, Komisioni vëren se kjo kërkesë ligjore ka të bëjë me detyrimin për deklarim dhe dorëzim të deklaratës individuale të të ardhurave, por nuk e përjashton individin nga pagesa e detyrimit tatimor në momentin që lind një i tillë, pavarësisht nga vlera e tij.

10.24. Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit tek i cili referohet subjekti në mbështetje të pretendimit të tij, ka të bëjë me një rrethanë të ndryshme nga ajo e rastit konkret. Tashmë në jurisprudencën e Kolegjit⁴² është konsoliduar qëndrimi për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjeteve, duke e konsideruar fitimin e realizuar nga shitja e automjeteve për të cilin nuk provohet pagimi i detyrimit tatimor, si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

10.25. Për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me kryerjen e analizës financiare në datën 15.9.2010, Komisioni thekson se në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht është bazuar në burimin financiar të deklaruar nga subjekti, pra të në ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***.

10.26. Gjithsesi, edhe nëse merret në konsideratë pretendimi i subjektit për përfshirjen e të ardhurave të tjera të realizuara gjatë vitit 2010 si burim për blerjen e automjetit, Komisioni vëren se sërish subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 113.308 lekë për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë vit, bazuar kjo në analizën financiare të vitit 2010 (në kushtet që gjatë vitit 2010 subjekti ka kryer shpenzime mobilimi, për të cilat nuk mund të përcaktohet saktësisht data e pagesës, Komisioni iu referua analizës financiare në fund të vitit).

10.27. Në përfundim të analizës së pretendimeve të subjektit, Komisioni konkludon se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për shumën 182.765 lekë për blerjen e automjetit, duke u gjendur në këto kushte në parashikimet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

10.28. Në lidhje me deklarin jo të saktë të subjektit në DIPP-në e vitit 2010, Komisioni vlerëson se ky deklarim merr vlerë në përfundimet e analizës financiare të kryer po nga Komisioni për të verifikuar nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur mjete financiare të ligjshme për pasuritë dhe shpenzimet e kryera. Fakti që subjekti rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme, në kryerjen e analizës financiare, e vendos atë në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për efekt të analizës financiare.

11. Aksionet në shoqërinë “*”**

⁴²Vendimet: nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019 dhe nr. 34-2019 (JR), datë 2.12.2019.

11.1. Nga hetimi i Komisionit⁴³ rezultoi se subjekti i rivlerësimit Erion Çelaj figuron aksioner, zotërues i 50 aksioneve të shoqërisë “****” sh. a. Gjithashtu, prindërit e subjektit N. dhe F. Ç. figurojnë aksionerë dhe zotërojnë secili nga 75 aksione të shoqërisë “****” sh. a.

11.2. Sa më sipër rezulton, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting* zotërimin e 50 aksioneve të shoqërisë “****” sh. a., në kundërshtim me dispozitat e gërmës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

11.3. Rezulton se shoqëria “****” sh. a., me anë të shkresës nr. *** prot., datë 26.12.2017, ka konfirmuar se nga momenti i fitimit të titullit të pronësisë mbi aksionet e shoqërisë “****” sh. a., deri në datën e kësaj shkrese, në të gjitha mbledhjet e asamblesë së aksionerëve, është vendosur mosshpërndarja e dividendit. Shoqëria “****” sh. a., me NIPT **, është e regjistruar në sistemin SPE dhe është shpallur fituese në procedurat e prokurimeve elektronike, si dhe në procedurat e prokurimit “me negociim pa shpallje paraprake të kontratës” deri më 25.1.2017, si vijon: në vitin 2009 është shpallur fituese në total në 3 procedura; në vitin 2010 është shpallur fituese në total në 3 procedura; në vitin 2011 është shpallur fituese në total në 5 procedura; në vitin 2012 është shpallur fituese në total në 11 procedura; në vitin 2013 është shpallur fituese në total në 29 procedura; në vitin 2014 është shpallur fituese në total në 46 procedura; në vitin 2015 është shpallur fituese në total në 35 procedura; në vitin 2016 është shpallur fituese në total në 61 procedura; në vitin 2017 është shpallur fituese në total në 3 procedura.

11.4. Referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, me ligjin nr. 44/2014, datë 24.4.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005”, në pikën 1 të nenit 21 përcaktohet se: *“Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”*. Në pikën 1, të nenit 24, të këtij ligji përcaktohet se: *“Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es”*.

11.5. Komisioni vëren se ligjvënësi ka përcaktuar mënyrat bazë të trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave nga zyrtarët, për parandalimin sa më të hershëm dhe sa më efikas të çdo konflikti interesi, të çdolloji qoftë ai. Referuar nenit 37 të ligjit nr. 9367, datën 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, me ligjin nr. 44/2014, datë 24.4.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, parashikohet se: *“Zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke transferuar a tjetërsuar interesat private”*.

11.6. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të

⁴³Shkresë nr. *** prot., datë 20.1.2021, e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën Vetting zotërimin e 50 aksioneve të shoqërisë “***” sh. a., në kundërshtim me dispozitat e germës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003; (ii) në lidhje me pronësinë e 50 aksioneve dhe 150 aksioneve në emër të prindërve N. dhe F.Ç., subjekti i rivlerësimit është në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, për sa kohë ka poseduar aksione të një shoqërie, që në vijimësi ka përfituruar fonde publike si më lart.

11.7. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: “Për zotërimin e 50 aksioneve të shoqërisë ‘***’ sh. a. në emrin tim jam vënë në dijeni gjatë pyetjeve të bëra nga ILDKPKI-ja në vitin 2021. Këto aksione janë përfituruar nga babai im N.Ç. si punonjës i shoqërisë në momentin e privatizimit. Ka qenë ai që më ka shkruar edhe emrin për zotërimin e këtyre aksioneve. Nga momenti që jam bërë zotërues deri sot nuk kam firmosur asnjë dokumentacion në cilësinë e aksionarit. Nuk gjendet asnjë vendim asambleje i aksionarëve që unë mund të kem firmosur për vendimet e marra dhe, gjithashtu, nuk kam përfituruar asnjë qindarkë nga ndonjë shpërndarje dividendi të kryer nga kjo shoqëri.

11.8. Vlera e këtyre aksioneve është një vlerë simbolike dhe e parëndësishme në volumin e aksioneve të kësaj shoqërie. Kam qenë në padijeni totale që unë dhe prindërit e mi zotërojmë këto aksione, pasi asnjëri prej nesh nuk ka nënshkruar qoftë edhe një dokument të ligjit nr. 9049/18 të vetëm. Nuk e di çfarë fondesh publike ka marrë kjo shoqëri dhe nuk di as volumet e shitjes apo fitimet e realizuara.

11.9. Vlerësoj se është e qartë se unë personalisht, por edhe prindërit e mi nuk kanë asnjë lloj interesi aktiv në lidhje me aktivitetin e shoqërisë. Këto aksione rezultojnë që në momentin e privatizimit dhe kanë mbetur ende si të tilla. Aktualisht shoqëria ‘***’ sh. a. ka 18.250.000 aksione dhe vlera nominale e aksionit është 1.000 lekë. Unë dhe prindërit e mi kemi gjithsej 200 aksione dhe vlera nominale e tyre është 200.000 lekë, të cilat janë pothuajse të papërfillshme në raport me vlerën nominale të kapitalit të regjistruar që është 18.250.000.000 lekë”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.10. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

11.11. Subjekti i rivlerësimit, pavarësisht faktit që pretendon se nuk ka qenë në dijeni, nuk ka firmosur asnjë dokument, por dhe në konsideratë të faktit se vlera nominale e aksioneve është e papërfillshme në raport me fitimin e kësaj shoqërie, duhet të kishte deklaruar të drejta reale, të cilat parashikohen nga ligji si detyrim për deklarim.

11.12. Komisioni vlerëson se ndonëse subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një deklarimi të pasaktë, kjo pasaktësi nuk passjell si pasojë penalizimin e tij.

12. Analiza financiare

12.1. Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur për periudhën 2003 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë qenë në pamundësi për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite dhe, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 361.974 lekë në vitin 2007*⁴⁴.

12.2. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, nuk paraqiti shpjegime apo prova për balancën negative të vitit 2007, në vlerën 361.974 lekë, por dha shpjegime vetëm për barrën e provës për balancën negative 258.428 lekë të automjetit me targa *** (trajtuar në pjesën përkatëse të vendimit).

12.3. Në këto kushte mbetet konstatimi fillestar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në vitin 2007, në vlerën 361.974 lekë⁴⁵ për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

12.4. Në konkluzion të vlerësimit të kriterit të pasurisë, bazuar në konkluzionet për çdo pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e parashikuara në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

29. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, ka dërguar raport për kontrollin e figurës së subjektit Erion Çelaj, duke konkluduar me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

30. Në vazhdim përcillet raporti vijues për kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 8.3.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 18.3.2021, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohë shtrirjeje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit, në disa raste, rezulton se: “(i) gjatë periudhës në të cilën z. Erion Çelaj ushtronte detyrën si prokuror dyshohet se është përfshirë në veprime

⁴⁴Ku është e përfshirë edhe barra e provës e kaluar paragrafin 9.10 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

⁴⁵E përbërë nga vlera 258.428 lekë (e trajtuar te blerja e automjetit me targa ***) dhe diferenca prej 103.546 lekësh.

korruptive në vitet 2011 dhe 2016; (ii) gjithashtu, subjekti, në cilësinë e prokurorit [...] ka ushtruar ndikim të paligjshëm në disa procese penale; (iii) [...] kanë informuar Prokurorinë e Krimeve të Rënda [...] për veprimtari të kundërligjshme në sistemin e drejtësisë në Vlorë; (iv) në lidhje me subjektin e rivlerësimit Erion Çelaj, jemi informuar [...] për kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar [...]”.

31. Sa më sipër, situata pasqyron korrupsionin sistematik në vetë sistemin e drejtësisë, ku në rastin në fjalë përfshihet në veprime korruptive një prokuror. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale “krimi i organizuar, trafikim dhe korrupsion”. Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në periudha të shkëputura kohore e në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt për të kryer ose moskryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, e bën subjektin e rivlerësimit individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale. Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për atë vetë si funksionar publik apo për persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit apo të personave të tjerë, vlerësohet se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së tij.

32. Në përfundim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në *papërshtatshmëri* në vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Erion N. Çelaj.

Hetimi i kryer nga Komisioni

33. Në vijim të informacioneve të mësipërme, në bazë të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në bashkëpunim dhe në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar, ka kryer disa aksese në dokumentacionin e klasifikuar të poseduar nga institucionet verifikuese për t’i studiuar ato, si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve në të cilat kishin arritur raportet e sipërpërmendura.

34. Komisioni kërkoi informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme⁴⁶ nëse ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 2.6.2021, rezultoi se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier⁴⁷ janë regjistruar këto referime penale ndaj subjektit Erion Çelaj: (i) kallëzimi penal nr. ***, datë 13.12.2012, mosfilluar në datën 27.12.2012; (ii) kallëzimi penal nr. ***, datë 12.1.2021, mosfilluar në datën 28.1.2012; (iii) kallëzimi penal nr. ***, datë 18.1.2021, mosfilluar në datën 2.2.2021.

⁴⁶Shkresë nr. ***, datë 13.1.2021.

⁴⁷Shkresë nr. *** prot., datë 2.2.2021.

35. Komisioni kërkoi informacion pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁴⁸ nëse ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 28.1.2021, është informuar se subjekti përmendet si i kallëzuar bashkë me funksionarë të tjerë të drejtësisë, në kuadrin e procedimit penal nr. ***, viti 2019, i cili ka ardhur për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Pas kryerjes së verifikimeve, është vendosur dërgimi i akteve për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 11.5.2020. Më tej, ndaj subjektit është regjistruar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2020, për të cilin, pas verifikimit, është vendosur mosfillim procedimi. Gjithashtu, në ngarkim të subjektit janë dërguar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dy materiale kallëzuese, të cilat janë vlerësuar të dërgohen për kompetencë në Prokurorinë e Përgjithshme⁴⁹. Ndërkohë që, pas verifikimit të regjistrimit të njoftimit të veprave penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk rezulton që ndaj subjektit Erion Çelaj të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

36. Më tej, Komisioni administroi dosjet penale për të cilat kishte *indicie* për përfshirjen në veprimtari korruptive gjatë viteve 2011 – 2016, por dhe pas kësaj periudhe, duke verifikuar nëse *indiciet* mund të ndikonin në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit në kontrollin e figurës apo kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit, në vlerësimin tërësor të procedurës së rivlerësimit. Gjithsesi, këto dosje të administruara nga Komisioni janë pasqyruar në seksionin konstatime të tjera lidhur me procedurën e rivlerësimit.

37. Në përfundim të hetimit të kontrollit të figurës, në analizim të dokumentacionit të administruar, raportit të dërguar nga DSIK-ja, si dhe verifikimit të të dhënave pranë organeve shtetërore kompetente, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: *Duket se për subjektin e rivlerësimit ka informacione dhe konstatime, që cenojnë figurën e tij dhe e bëjnë atë të ndikueshëm në ushtrimin e detyrës.*

38. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se: Nga verifikimet e kryera nga Komisioni nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që mbështet konkluzionet e arritura nga DSIK-ja. Së pari, nuk ka asnjë shpjegim se pse DSIK-ja ka ndryshuar konkluzion nga i përshtatshëm në të papërshtatshëm. Raporti i parë i është dërguar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, dhe ky raport konfirmonte përshtatshmërinë e subjektit. Në raportin e dytë hidhen dyshime se subjekti ka kryer veprime korruptive në vitet 2011 dhe 2016. Subjekti pretendon se si është e mundur që deri në fund të vitit 2017 DSIK-ja nuk e kishte këtë informacion dhe se është jologjike të mendohet se institucionet e inteligjencës erdhën në dijeni apo krijuan dyshime për veprime korruptive të kryera nga një funksionar i drejtësisë 8-9 vjet më pas se ky veprim dyshohet të këtë ndodhur. Sipas subjektit mjafton vetëm ky argument për ta konsideruar informacionin e DSIK-së si të pabesueshëm, subjektiv dhe dashakeqës. Së dyti, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka detyrimin ligjor të kalojë barrën e provës te subjekti i rivlerësimit për çdo gjetje, që sipas vlerësimit të këtyre organeve, përbën mospërbushje të

⁴⁸Shkresë nr. ***, datë 13.1.2021.

⁴⁹Respektivisht me shkresat nr. *** prot., datë 29.12.2020 dhe nr. *** prot., datë 29.12.2020.

detyrimet ligjor nga subjekti dhe ka si sanksion marrjen e një mase disiplinore, pra të një dënimi administrativ.

Arsyetimi i Komisionit

39. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit *se si është e mundur që deri në fund të vitit 2017, kohë kur dërgohet raporti i DSIK-së me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, dhe ky raport konfirmonte përshtatshmërinë e subjektit nuk e kishte këtë informacion dhe se është jologjike të mendohet se institucionet e inteligjencës erdhën në dijeni apo krijuan dyshime për veprimeve korruptive të kryera nga një funksionar i drejtësisë 8-9 vjet më pas se ky veprim dyshohet të këtë ndodhur, ndërkohë që në raportin e dytë hidhen dyshime se subjekti ka kryer veprime korruptive në vitet 2011 dhe 2016, nuk është i bazuar në ligjin nr. 84/2016, për shkak se detyrimi i DSIK-së për t'u shprehur për përshtatshmërinë ose jo të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën buron nga parashikimi i pikës 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton: “[...] DSIK-ja, në raportin për kontrollin e figurës, shprehet për konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës”.*

40. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se DSIK-ja, si organ kompetent, është shprehur për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Erion Çelaj për vazhdimin e detyrës, me shkresën nr. *** prot., datë 8.3.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 18.3.2021, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Ky raport i rishikuar nga DSIK-ja ka ardhur gjatë procesit të hetimit dhe në bashkëpunimin me Komisionin sipas kërkesave të nenit 36 të ligjit nr. 84/2016 si organet përgjegjëse për kontrollin e figurës.

41. Në lidhje me pretendimin e subjektit se *Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka detyrimin ligjor të kalojë barrën e provës te subjekti i rivlerësimit për çdo gjetje, që sipas vlerësimit të këtyre organeve përbën mospërmbyshje të detyrimit ligjor nga subjekti*, Komisioni thekson se barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, nëse Komisioni pas hetimit kryesisht të këtyre informacioneve të evidentuara nga raporti i kontrollit të figurës nga Grupi i Punës pranë DSIK-së, arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë. Për këtë arsye, Komisioni, në seksionin konstatime të tjera, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve që kanë dalë nga hetimi i këtyre çështjeve të administruara për shkak të këtyre informacioneve.

42. Në përfundim të analizimit të pretendimeve të subjektit, Komisioni çmon se pretendimet e subjektit nuk janë të bazuara në ligj, për aq sa secili institucion ka kryer detyrën brenda kompetencave që i njeh ligji. Për aspektin e provueshmërisë së informacionit nga DSIK-ja, Komisioni do të vlerësojë secilin rast veçmas në konstatimet e tjera në këtë vendim.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

43. Subjekti i rivlerësimit Erion Çelaj ka ushtruar funksionin e prokurorit: në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në periudhën 1998 – 2000; në periudhën 2000 – 2004 ka ushtruar funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; në periudhën 2004 – 2007 ka ushtruar funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; në periudhën maj 2007 - maj 2008 ka ushtruar funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; në periudhën 1.12.2011 – 21.1.2013 ka ushtruar detyrën e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; në periudhën 21.1.2013 – 23.10.2019

ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë; në periudhën 23.10.2019 – 26.1.2021 ka ushtruar detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë; në datën 27.1.2021, me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë dhe, njëkohësisht, është caktuar përkohësisht drejtues i kësaj Prokurorie.

44. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi” ka miratuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

45. Referuar të dhënave arkivore pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, për subjektin e rivlerësimit Erion Çelaj rezulton se nuk janë dhënë masa disiplinore. Gjithashtu, nuk ka të dhëna apo informacione për cenim të figurës së subjektit të rivlerësimit. Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në Sektorin e Protokollit dhe Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se ndaj subjektit është paraqitur 1 ankesë – praktika nr. ***, e vitit 2019, nga shtetasja K. H., e cila ankohet se banesa e saj është grabitur dhe janë shkaktuar dëme në ambientet e saj. Sipas shtetases, subjekti Erion Çelaj e ka mbyllur çështjen për mungesë provash pa e njoftuar. Kjo praktikë është trajtuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe ankuesja është orientuar të paraqesë ankim ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

46. Sa më sipër, lidhur me aftësitë profesionale, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Erion Çelaj shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në vlerësimet e punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të tij, si në hetimet dhe gjykimet që ka ndjekur personalisht, ashtu edhe në menaxhimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve që ka pasur në ndjekje. Rezulton se për periudhën e rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, subjekti ka trajtuar gjithsej 587 çështje nga të cilat për 194 çështje është vendosur mosfillimi, 57 çështje janë pushuar, 106 çështje janë dërguar për gjykim dhe 230 çështje janë pezulluar. Subjekti ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ka kryer, drejtuar dhe kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve.

Hetimi i kryer nga Komisioni

47. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv dhe ankesave të paraqitura pranë Inspektoratit të KLD-së. Pas analizimit të tyre u konstatuan këto problematika dhe u kërkuan shpjegime e prova për sa vijon:

48. Çështja penale nr. *, e vitit 2015**, që i përket të pandehurit D.H., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake” të parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal. Rrethanat e faktit – rezulton se procedimi ka filluar mbi bazën e informacioneve të marra nga oficeri i policisë gjyqësore pranë Seksionit të Luftës kundër Trafiqueve në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, ku nga burime konfidenciale janë vënë në dijeni se shtetasi D.H., banor i qytetit të Gjirokastrës, është vënë në kontakt me një person banor në qytetin e Vlorës, me të cilin ka lidhje shoqërore dhe i ka komunikuar se dispononte një sasi të madhe lënde plasëse, që do të sillleshin në qytetin e Vlorës me qëllim kryerjen e veprave kriminale. Nga Prokuroria është autorizuar vëzhgimi dhe përgjimi ambiantal e telefonik i të dyshuarve për veprën penale “mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, kryesisht të llojit “eksploziv C4” në sasi të mëdha, vepër kjo e parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal, për të cilin ky shtetas dyshohej se kishte aktivitet kriminal dhe me persona të tjerë të pidentifikuar për momentin. Nga komunikimet që ka bërë personi i autorizuar, rezulton se shtetasi me emrin D.H. ndodhej në L., Fier. Në kohën që është konstatuar i dyshuari D.H. për në drejtim të rrugës që të çon në hyrje të autostradës për në Vlorë, në kthesën për në autostradën Levan – Vlorë është bërë ndërhyrja nga policia dhe kapja e të dyshuarit. Nga kontrolli ndaj tij ka rezultuar se kishte me vete një sasi lënde plasëse, të cilën e kishte futur në xhepin anësor të pantallonave në krahun e majtë të mbështjellë me dy qese plastike, ku njëra ishte me ngjyrë të bardhë dhe tjetra në ngjyrë rozë dhe është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik-balistik të lëndës së sekuestruar me cilësinë e provës.

48.1 Gjithashtu është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit D.H., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje të armëve dhe municionit luftarak”, e parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal. Sipas aktekspertimit teknik-balistik nr. ***, datë 14.7.2015, ka rezultuar se lënda objekt ekspertimi e presuar në formë të tri kallëpeve është lëndë eksplozive e fabrikuar e fuqisë së mesme, me efekt brizantues të shpërthimit, e llojit TNT (tritol), me shpejtësi detonimi rreth 7200 m/sek. Lënda plasëse objekt ekspertimi është e rregullt teknikisht dhe shpërthen normalisht duke u iniciuar nga një gyp ndezës që mund të jetë kapsollë detonatore me fitil zjarrpërcjellës ose kapsollë elektrike.

48.2. Në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, subjekti ka arsyetuar mbi kërkimet e tij kualifikimin ligjor të veprës penale, analizën ligjore dhe faktike të saj, duke bërë një analizë të elementëve të figurës së veprës penale, mekanizmin e kryerjes së veprës penale, anën subjektive të të pandehurit në raport me veprën penale dhe me provat. Rezulton se nga ana e të pandehurit D.H. janë konsumuar tërësisht elementet e veprës penale “mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”.

48.3 Më anë të shkresës nr. *** prot., datë 4.6.2021, Komisioni kërkoi administrimin e fashikujve të procedimit penal nr. ***, pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe dosjen gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁵⁰. Pas analizimit të materialeve përkatëse⁵¹, rezultoi sa vijon: subjekti i rivlerësimit, në datën 5.5.2015, ka nxjerrë urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore dhe në datën 27.5.2015 ka regjistruar procedimin penal; në datën 27.8.2015, subjekti ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve deri në

⁵⁰Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2021.

⁵¹Shkresat: nr. *** prot., datë 9.6.2021 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nr. *** prot., datë 8.6.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

datën 27.11.2015, pasi në funksion të këtij procedimi, për sqarimin e rrethanave të çështjes, duhet të kryhen disa veprime hetimore, si eksperimentet teknike-balistike, verifikimi dhe pyetja e personave që kanë dijeni për rrethanat e çështjes etj. dhe në varësi të tyre edhe kryerja e veprimeve të tjera, të cilat nuk ka qenë e mundur të kryhen brenda afatit për shkak edhe të lejes vjetore; në datën 27.11.2015, subjekti ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve deri në datën 27.12.2015 për kryerjen e disa veprime të tjera hetimore të nevojshme, të cilat nuk janë kryer brenda afatit për shkak edhe të pamundësisë objektive të prokurorit; në datën 7.4.2016, subjekti ka paraqitur në gjykatë konkluzionet përfundimtare, duke kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit D.H., për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak”⁵², e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale uljen me 1/3 e dënimit.⁵³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në vendimin nr. ***, datë 10.5.2016, arsyeton se i pandehuri mban përgjegjësi për krimin e parashikuar nga neni 278/6 të Kodit Penal. Në lidhje me masën e dënimit gjykata çmon që i pandehuri duhet të dënohet me burgim në masën 5 vjet, masa minimale e parashikuar nga dispozita. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, i zbritet një e treta e dënimit të caktuar dhe i pandehuri dënohet përfundimisht me 3 vjet e katër muaj; në datën 23.5.2016, subjekti ka paraqitur apel kundërshtues kundër apelit të bërë nga shtetasi D.H., kundër vendimit ***, datë 10.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke kërkuar rrezimin e apelit të të pandehurit, duke arsyetuar se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale me veprime të drejtpërdrejta duke prodhuar sende shpërthyes. Këto veprime të paligjshme i ka kryer duke përzierë nitrat amoni dhe naftë. Në këtë mënyrë kualifikimi i veprimeve të tij përcaktohet sipas paragrafit 1, të nenit 278, të Kodit Penal.

49. Për sa rezultoi nga hetimi, Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me konstatimet se: Nuk është shumë i qartë kualifikimi i veprës penale “mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”, pasi në datën 11.12.2015, në kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. *,**

⁵²“Nga të gjitha materialet dhe provat shkresore të administruara në fashikullin e gjykimit të kësaj çështjeje⁵² rezulton se rrethanat dhe faktet në ngarkim të tij krijojnë bazën e të dhënave të bazuara në prova që ky shtetas me veprimet e tij të ketë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal. Nga të dhënat e administruara në gjykim provohet se sasia e lëndës plasëse që i është sekuestruar shtetasi D.H. është lëndë eksplozive e fabrikuar e fuqisë së mesme e llojit TNT (tritol) dhe në gjendje të rregullt teknike dhe për mbajtjen e tyre ky shtetas nuk disponon leje nga organet kompetente. Kështu, në rrethanat kur lënda plasëse (armë shpërthyes) e plotëson kushtet dhe kriteret e armëve të zjarrit në kuptim të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, kemi të bëjmë me mbajtje pa leje të tyre. Duke i mbajtur me vete këto lëndë në mjedis publik ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal.

⁵³Në konkluzionet përfundimtare subjekti ka arsyetuar sa vijon: “Me vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka vendosur shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55 dhe të paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr. 144/2013, ndryshuar me ligjin nr. 98/2014. Ky vendim ka hyrë në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare nr. 31, datë 29.2.2016. Në këto kushte, duke mos mbetur asnjë efektet e ligjit ndryshues në fuqi, nuk ka asnjë pengesë në mbetjen në fuqi të nenit 278 të Kodit Penal, siç ka qenë përpara ndryshimeve të vitit 2013 dhe vitit 2014. Po ashtu, nuk ka asnjë pengesë që lidhur me këtë nen të aplikohet dispozita favorizuese që ka qenë në fuqi me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 të ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’. Pra, sipas arsytimit të subjektit dispozitat e paragrafëve të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal (para shtesave të bëra me ligjin nr. 135/2015), janë aktualisht në fuqi. Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar vetëm marzhet e dënimit si joproporcional, që nuk i përgjigjet dukshëm rrezikshmërisë shoqërore të veprës, në raport me veprat e tjera të këtij seksioni dhe të tjerat në Kodin Penal (shihni pikat 28, 43, 46, 47, 51, 52, 53 dhe 54 të vendimit nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese). Në rastet kur paragrafi i pestë i nenit 278 të Kodit Penal është shfuqizuar, nga rrethanat e faktit rezulton se i pandehuri D.H. me veprimet e tij të kundërligjshme ka konsumuar veprën penale “mbajtje e lëndëve plasëse” dhe duhet të deklarohet fajtor sipas nenit 278/2 të Kodit Penal. Në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjykata duhet të mbajë parasysh kriteret e përcaktuara në nenet 47, 48,49, 50 “b”, “i” dhe vijues të Kodit Penal dhe, konkretisht, rrezikshmërinë e veprës, autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat e kryerjes së saj. Rrezikshmëria e veprës është e madhe duke pasur parasysh faktin që ka një marzh dënimi me burgim, si dhe përhapjen e madhe të saj kohët e fundit, rrezikshmëria e të pandehurit duhet konsideruar e madhe duke pasur parasysh se ai është i padënuar më parë, qëndrimin e të pandehurit D.H., si gjatë hetimeve edhe gjykimit. Gjithashtu, gjykata, në dhënien e dënimit në bazë të nenit 49 të Kodit Penal duhet të mbajë parasysh gjendjen e tij të vështirë familjare, ekonomike dhe social-kulturore”.

subjekti e ka kualifikuar veprën penale sipas përcaktimeve në nenin 278/5 të Kodit Penal - “mbajtje e armëve, bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga 7 deri në 15 vjet”, ndërkohë që pas ndryshimeve të pësuara (me vendimin e Gjykatës Kushtetuese), në konkluzionet përfundimtare të paraqitura në gjykatë në datën 7.4.2016, e kualifikon veprën penale sipas paragrafit të dytë, të nenit 278, të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, pra para ndryshimeve të pësuar në kod “mbajtje, blerje ose shitje e armëve, bombave apo minave pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në 7 vjet” - sakaq nga hetimi rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dhënien e vendimit, është bazuar në kualifikimin e veprës penale sipas përcaktimeve në nenin 278/6 të Kodit Penal, pas ndryshimeve të pësuara – *“Po kjo veprë e parashikuar nga paragrafi i pestë i këtij neni, kur kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga 7 deri në 15 vjet”*.

50. Subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se akuza e ngritur prej tij për të pandehurin është njoftuar përpara se Gjykata Kushtetuese të merrte vendimin nr. *, datë 26.2.2016. Për këtë arsye i pandehuri është akuzuar sipas përcaktimeve në nenin 278/5 të Kodit Penal në kohën e ngritjes së akuzës. Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj të sipërcituar, ka vendosur: *“Shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, si dhe të paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, ndryshuar me ligjin nr. 98/2014”*. Meqenëse Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar si joproportional dënimin e parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 55 dhe paragrafi i pestë dhe i gjashtë i nenit 278 të Kodit Penal, dispozita e zbatueshme do të jetë paragrafi i dytë i nenit 278, në versionin e ndryshuar deri në vitin 2001. Dispozita në fjalë, parashikon se: *“Mbajtja e armëve, bombave apo minave, lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet”*.**

51. Konkluzionet përfundimtare dhe gjykimi i kësaj çështjeje penale është zhvilluar shumë pak kohë pasi kishte hyrë në fuqi vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Në atë kohë ka pasur shumë diskutime për cilësimin juridik të veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” për shkak edhe të ndryshimeve ligjore që hynë në fuqi po në fillim të vitit 2016 sipas parashikimeve të ligjit nr. 135/2015. Në atë kohë pati vendimmarrje të ndryshme për mënyrën se si do të cilësoheshin veprimet e kryera nga të pandehurit, nga momenti që u kryen ndryshimet në nenin 278 sipas ligjit nr. 144/2003 dhe ligjit nr. 98/2014, deri në momentin e marrjes së vendimit nga Gjykata Kushtetuese. Subjekti deklaroi se në vendimet nr. *, datë 2.6.2016, nr. ***, datë 8.2.2017, nr. ***, datë 7.6.2017 dhe nr. ***, datë 29.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është mbajtur qëndrimi se cilësimi juridik duhet të kryhet në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal, me ndryshimet e vitit 2001 dhe para ndryshimeve të ligjit në vitet 2013 dhe 2014. Subjekti, në cilësinë e provës, paraqiti vendimin nr. ***, datë 2.6.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.**

52. Në përfundim të analizimit të përgjigjeve dhe provave të paraqitura në përgjigje të barrës së provës, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm arsyet e kualifikimit ligjor të veprës penale në konkluzionet e tij përfundimtare të paraqitura në gjykatë.

53. Në lidhje me kallëzimin penal nr. *, datë 1.9.2014**, mosfilluar më 21.11.2014, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Rrethanat e faktit – në datën 27.8.2014 është konstatuar se në lagjen “****”, Vlorë, në rrugën “****” shtetasi M.Xh., i cili ka në pronësi të tij një objekt, banesë në katin e parë të një pallati ***-katësh, po në këtë lagje, ka ndërtuar një objekt “shtesë” ballkoni, ngjitur me banesën e tij. Ndërtimi i këtij ballkoni ishte me përmasa, në pjesën përpara dy anësoreve të ballkonit nga 50 cm, e cila ka një hyrje në derën kryesore të kësaj banese dhe në dy pjesët anësore me gjerësi 70 cm dhe lartësi të përgjithshme 90 cm janë konstatuar punime ndërtimi pa leje të organeve përkatëse⁵⁴.

53.1 Subjekti, në datën 21.11.2014, ka vendosur “mosfillim të procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, viti 2014”, mbështetur në germën “ç” të nenit 290/1 dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në vendim arsyetohet se natyra e veprimeve aktuale për riparim apo ndërtim dhe zbukurim që janë konstatuar, sikur të konsiderohen të kryera nuk janë të mjaftueshme për realizimin e konceptit të “ndërtimit pa leje”, pasi në të kundërt do të përjashtohet çdo situatë verifikimi, trajtimi dhe sanksionimi administrativ i fakteve të tilla. Objekti i ndërtimit ballkon, nuk i plotëson kriteret e ndërtimit të një objekti të ndërtimit. Në këto rrethana nuk konstatohet fakti penal i parashikuar në nenin 199/a “ndërtim i paligjshëm”, i Kodit Penal, dhe nuk konstatohen elementë të ndonjë veprë penale. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 5.12.2014, ka njoftuar subjektet e interesuara dhe shtetasin M.Xh. lidhur me vendimin e mosfillimit të procedimit penal.

53.2 Komisioni vëren se bazuar në nenin 45, të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, citohet: “Çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj që do të ndërtojë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të pajiset me leje ndërtimi. Ky është dokumentacioni i vetëm ligjor mbi bazën e të cilit lejohet ndërtimi”. Në nenin 48, të këtij ligji, përcaktohet se leja e ndërtimit kërkohet për kryerjen e punimeve “ndërtime të reja të çdolloji, mbi e nëntokësore ...”, “rrethime të përkohshme dhe të përhershme”. Subjekti, në vendimin e mosfillimit, nuk arsyeton dhe nuk bën referencë mbi bazën ligjore, në të cilën i kategorizon veprimet e kryera dhe nuk referon nëse gjendet në kushtet e përcaktuara në nenin 52 “Kundërvajtje administrative” të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Në referim të pikës 3, të nenit 73 “Aftësitë profesionale të prokurorit”, të ligjit nr. 96/2016, aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit. Më tej evidentohet se kallëzimi penal është regjistruar në datën 1.9.2014 dhe vendimi i mosfillimit

⁵⁴Veprimet hetimore: Nga shërbimet e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Vlorë është proceduar me administrimin e raportit të shërbimit datë 27.8.2014, procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, procesverbalin e këqyrjes së marrjes së dokumenteve (kopje), si dhe procesverbalin e pyetjes së shtetasit M.Xh. në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethana të hetimeve. Gjatë verifikimeve ka rezultuar se shtetasi i mësipërm nuk është i pajisur me leje nga organet përkatëse për ndërtimin e shtesës së ballkonit përpara banesës së tij. Prokuroria ka dokumentuar faktin penal duke bërë këqyrjen e vendit të ngjarjes, shoqëruar më tabelat fotografike. Është thirrur dhe pyetur në cilësinë e personit me dijeni për veprën penale shtetasi M. Xh., i cili në deklarinimin e tij ka shpjeguar se ballkonin në fjalë e ka ndërtuar brenda rrezes së ballkoneve të mësipërme të pallatit me qëllim parandalimin e ujërave të shirave dhe fekaleve, të cilat grumbullohen përpara derës kryesore për në hyrjen e objektit të tij.

është dhënë në datën 21.11.2014, çka rezulton se është shqyrtuar dhe zgjidhur tej afatit 1-mujor të përcaktuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilin përcaktohet se afati i shqyrtimit të kallëzimit penal është 30 ditë.

53.3 Për sa rezultoi nga hetimi, Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me konstatimin se: *Në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, subjekti nuk ka arsyetuar mbi bazën ligjore në të cilën janë kategorizuar veprimet e ndërtimit pa leje të kryera nga shtetasi M.Xh., si dhe ky vendim është marrë tej afatit 30-ditor të përcaktuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm.*

54. Subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se: *“Në vendimin e mosfillimit është analizuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje administrative. Në kohën kur janë kryer punimet objekt i këtij procedimi penal (rreth muajit korrik të vitit 2014) ka qenë në fuqi ligji nr. 10/119, datë 23.4.2009⁵⁵. Për të verifikuar nëse në rastin konkret ish-in përpara veprës penale të ‘ndërtimit pa leje’ ishte e nevojshme një këqyrje më e hollësishme e shoqëruar me tabelë fotografike. Oficeri i policisë gjyqësore ka kryer këqyrjen në datën 20.11.2014 dhe një ditë më pas është marrë edhe vendimi i mosfillimit. Siç shihet nga tabela fotografike e pasqyruar në faqet 24-25 të dosjes, muri i ndërtuar është në një vëllim apo madhësi të parëndësishme dhe, si i tillë, nuk kërkon leje ndërtimi por deklaratë paraprake punimesh. Si rrjedhojë nuk mund të konsiderohet se në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale, por me një shkelje administrative. Për shkak të ngarkesës së madhe është i vështirë respektimi me rigorozitetin e afatit të marrjes së vendimit të mosfillimit. Para ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 nuk ka pasur afat të përcaktuar ligjor për marrjen e vendimit të mosfillimit. Në rastet më të shpeshta vonesat bëhen nga vonesa e ardhjes së akteve plotësuese (siç ka qenë në rastin konkret tabela fotografike), pa të cilat formalisht nuk mund të marrësh një vendim mosfillimi”.*

55. Në përfundim të analizimit të përgjigjeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti, në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, nuk ka arsyetuar mbi bazën ligjore në të cilën janë kategorizuar veprimet e ndërtimit pa leje të kryera nga shtetasi M.Xh. Gjithashtu rezulton se afatet ligjore për marrjen e vendimit të mosfillimit janë përcaktuar në udhëzimin nr. ***, datë 19.6.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, për pasojë, vendimi i subjektit është marrë tej afatit 30-ditor të përcaktuar në udhëzim, duke u gjendur në kushtet e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Gjithsesi, kjo mangësi e vetme nuk mund të jetë shkak për shkarkimin e subjektit, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurës së rivlerësimit.

DENONCIME

56. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Erion Çelaj, janë administruar 3 denoncime nga publiku. Lidhur me denoncimet nr. *** prot., datë 28.12.2020 dhe nr. *** prot., datë 22.12.2020, të shtetasit K.C., Komisioni vëren se paraqiten në formën e kallëzimit penal për disa subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe Erion Çelaj. Për këto dy denoncime u konstatua se nuk rezultuan *indicie* për hetime të mëtejshme ndaj subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë që, Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me denoncimin nr. *** prot., datë 25.11.2019, të paraqitur nga shtetasja L.P., e cila kërkon fillimin e procedimit disiplinor për subjektet e rivlerësimit, E.A. dhe Erion Çelaj.

⁵⁵Në këtë kohë ishte miratuar ligji nr. 107/2014, por ky ligj ka hyrë në fuqi më 1.10.2014.

57. Rrethanat e faktit – në vitin 2015 bashkimi i operatorëve “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. kanë ndërtuar një rrugë pa leje në plazhin e Palasës në kundërshtim me vendimin e Këshillit Teknik të ARRSH-së së vitit 2013. Një segment i kësaj rruge të ndërtuar jashtë projektit të miratuar kalonte në pronën e denoncueses, e cila ka depozituar kallëzim penal ndaj shoqërisë ndërtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Objekti i hetimeve të procedimit penal nr. *** ka qenë ndërtimi i paligjshëm i kryer në truallin e kallëzuesit F.P. Për hetimin e kësaj çështjeje është ngarkuar prokurore E.A. Denoncuesja sqaron se paralelisht me kallëzimin penal ka hapur një gjyq civil për ndalimin e punimeve dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme. Të dyja shkallët e gjykimit i kanë dhënë të drejtë denoncueses duke e konsideruar këtë segment rrugor si ndërtim të paligjshëm dhe, si rrjedhojë, është prishur ky ndërtim. Denoncuesja deklaroi se prokurorja E.A., në datën 11.5.2016, e ka pushuar procedimin penal, vendim të cilin e ka ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës dhe kthimin e dosjes për hetime të mëtejshme duke caktuar detyra për prokuroren, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë duke marrë formë të prerë më 1.12.2017⁵⁶.

58. Sa më sipër, denoncuesja deklaroi se ka depozituar kallëzimin penal nr. ***, viti 2018, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ndaj shtetasës E.A., për veprën penale “shpërdorim i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248, 25 dhe 28, të Kodit Penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin e datës 10.1.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të mësipërm. Ky vendim është ankimuar nga denoncuesja në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila ka vendosur “Pranimin pjesërisht të ankimit të paraqitur nga ankuesja L.P. kundër vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”, disponuar më 10.1.2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në lidhje me kallëzimin penal nr. ****”. Urdhërohet prokuroria të regjistrojë procedimin penal për veprën penale “shpërdorim i detyrës”, e parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal, duke kryer veprime hetimore në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës ose jo të elementëve të shpërdorimit të detyrës në ushtrimin e ndjekjes penale të kryer për llogari të procedimit penal nr. ***, viti 2015, të hetuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky vendim është ankimuar prej denoncueses në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, e cila ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 11.6.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda” – shfuqizimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal datë 12.1.2019, të prokurorit pranë Gjykatës për Krime të Rënda, në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, duke urdhëruar prokurorin të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme sipas urdhërimit, të përcaktuara në pjesën urdhëruese të këtij vendimi të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë”, konkretisht, për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, e kryer në bashkëpunim, në formën e Grupit të Strukturuar Kriminal, parashikuar nga nenet 248, 28, 333/a, 334 të Kodit Penal.

⁵⁶Më tej, denoncuesja sqaron se në datën 17.12.2018, prokurorja i është drejtuar përsëri gjykatës për të kërkuar pushimin e çështjes. Gjykata e Apelit Vlorë, përmes vendimit nr. ***, datë 25.6.2019, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 11.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilin është vendosur: “1. Rrëzimi i kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2018. 2. Kthimi i akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2018, prokurores E.A., duke urdhëruar kryerjen e këtyre veprimeve procedurale”.

59. Për sa rezultoi, denoncuesja ka paraqitur një kërkesë me shkrim⁵⁷ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për zëvendësimin e prokurores, por është njoftuar se dosja e procedimit penal nuk kishte mbërritur në Prokurori. Me të marrë dijeni se dosja kishte mbërritur, denoncuesja deklaroi se në datën 24.10.2019, i ka dërguar një kujtesë me shkrim Drejtuesit të kësaj Prokurorie, subjektit Erion Çelaj, për t'u shprehur në lidhje me kërkesën e saj. Gjithashtu, deklaroi se ka realizuar një takim me subjektin në datën 7.11.2019, në zyrën e tij në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë në lidhje me këtë çështje. Sipas denoncueses, subjekti i rivlerësimit i ka bërë me dije se ia kishte përcjellë dosjen prokurores dhe kjo e fundit nuk kishte pranuar të hiqte dorë nga çështja, dhe se ai nuk mund të ndërhynte. Në këto kushte, denoncuesja ankohet lidhur me vendimmarrjen e subjektit për moszëvendësimin e prokurores dhe, në përfundim, kërkon inicimin e procedimit disiplinor ndaj tij. Komisioni kërkoj shpjegime nga subjekti i rivlerësimit lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim.

60. Subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se: Referuar nenit 148 të Kushtetutës dhe nenit 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori, në ushtrimin e funksioneve të tij është i pavarur, çka nënkupton që qëndrimi i tij mbi çështjet bazohet vetëm në bindjen e brendshme në përputhje me provat dhe ligjin. Në rastin konkret, shtetasja L.P. kërkonte zëvendësimin e prokurores për shkak të vendimmarrjes së saj, si dhe për shkak të faktit se ajo kishte paraqitur kallëzim ndaj prokurores. Asnjë nga rastet e sipërcituara nuk përfshihet në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17, paragrafi I, germet “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”. Kallëzimi i bërë ndaj prokurores nuk është shkak për të zëvendësuar prokuroren. Nëse do të ishte kështu çdo i pandehur që nuk donte të procedohej nga një prokuror i caktuar do të paraqiste kallëzim ndaj tij. Subjekti sqaroi se në përfundim të hetimeve, çështja penale në ngarkim të shtetasit F.Gj. dhe shoqërisë “***”, të kallëzuar nga ankuesja L.P. është dërguar për gjykim.

61. Sa më sipër, pas analizimit të denoncimeve të paraqitura, Komisioni konstaton se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se denoncimi i trajtuar nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

62. Si konkluzion, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, problematikën e evidentuarë dhe të shqyrtuarë në këtë vendim vlerësohet se nuk përmbajnë shkelje serioze dhe nuk kanë shkaktuar pasoja të rënda procedurale për palët në mënyrë që subjekti i rivlerësimit të kualifikohet “i papërshtatshëm” nga ana profesionale.

Konstatime të tjera në vijim të informacioneve të marra

63. Në lidhje me konstatimin e pasqyruar nga DSIK-ja, në raportin për figurën e subjektit Erion Çelaj, Komisioni ka kryer një hetim të pavarur, nga i cili ka administruar nga organet ligjzbatuese të dhëna të marra nëpërmjet dokumentacionit të klasifikuar “sekret”, ku dëshmohej se si subjekti është përfshirë në veprime korruptive në vitet 2011 dhe 2016, por dhe më pas (në vitet 2017 - 2020), ku, në cilësinë e prokurorit, ka ushtruar ndikim të paligjshëm në disa procese penale; subjekti ka kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në

⁵⁷Kërkesë nr. *** prot., datë 8.10.2019.

krimin e organizuar, si dhe ka ushtruar ndikimin e tij me qëllim favorizimin e personave me të cilët kishte marrëdhënie.

64. Në lidhje me konstatimin e DSIK-së se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar, Komisioni, për të verifikuar këtë informacion sipas standardeve të kontrollit të figurës, përcaktuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, ndërmori hapat hetimorë sipas neneve 49 dhe 50 të këtij ligji.

65. Nga verifikimi në sistemin *TIMS* dhe konfirmimit të ardhur me shkresën nr. ***, datë 31.5.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në datën 7.12.2013 ka lëvizur me automjetin me targa ***, në pronësi të tij, së bashku me shtetasin F.D. dhe 2 shtetas të tjerë.

66. Komisioni e konsideroi të nevojshme të verifikojë lidhjen e subjektit të rivlerësimit me shtetasin F.D. Në këto kushte, me vendimin datë 28.5.2021⁵⁸, trupi gjykues vendosi të administrojë disa shkresa⁵⁹ nga fashikujt e dosjes së hetimit të një subjekti tjetër, me qëllim përdorimin e tyre në cilësinë e provave në kuadër të procesit të rivlerësimit për subjektin Erion N. Çelaj.

67. Pasi u analizua dokumentacioni i mësipërm, rezultoi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku subjekti ka qenë në pozicionin e drejtuesit, dhe më tej të prokurorit, ka regjistruar ndaj shtetasit F.D. procedimet penale, si vijon: (i) procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 28.11.2011, për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe më tej, me vendimin nr. ***, datë 28.2.2012, është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe është dënuar me 200.000 lekë gjobë; kjo çështje është hetuar nga prokurori E. A.; (ii) në datën 26.9.2014 shtetasi F.D. është hetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal; kjo çështje është hetuar nga prokurori K. Ll.; (iii) gjithashtu, nga hetimi i Komisionit rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka kryer hetime për procedimin penal nr. ***, të vitit 2013, në ngarkim të disa shtetasve shqiptarë, midis të cilëve si person nën hetim edhe shtetasi F.D., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “trafikim i narkotikëve”, i kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a, paragrafi II dhe 22 i Kodit Penal. Lidhur me këtë procedim penal shtetasi F.D. në fillim është akuzuar për kryerjen e veprës penale “trafikim i narkotikëve”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë, por prokuroria ka ndryshuar akuzën ndaj tij në pretendimet përfundimtare, duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Me vendimin nr. ***, datë 17.6.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit F.D. për kryerjen e veprës penale “moskallëzim krimi” dhe dënimin e tij me 1 vit burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale ulet 1/3 e dënimit, duke e dënuar

⁵⁸Vendimi nr. *** prot., datë 28.5.2021.

⁵⁹Shkresat: nr. *** prot., datë 15.3.2018, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.3.2018; nr. *** prot., datë 14.2.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.2.2018; nr. *** prot., datë 14.2.2018, drejtuar Prokurorisë së Krimeve të Rënda, kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.3.2018; nr. *** prot., datë 23.3.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kthim përgjigje shkresat e prokurorive të rretheve.

përfundimisht me 8 muaj burgim. Rezulton se ky shtetas është shpallur i pafajshëm për veprën penale për të cilën kishte qenë i dyshuar/akuzuar (“trafikim i narkotikëve”).

68. Në analizim të çështjeve të sipërpërmendura, shtetasi F.D. rezulton i dënuar disa herë për shkeljen e ligjit dhe kryerjen e disa veprave penale, fakte këto të njohura, të publikuara dhe të dokumentuara nga regjistrat përkatës të organeve ligjzbatuese, ku subjekti i rivlerësimit nuk mund të mos kishte dijeni, duke qenë se: (i) ka qenë Drejtues i Prokurorisë për veprën e parë të regjistruar në vitin 2011 dhe në rolin e drejtuesit, në varësi të ngarkesës së punës, kryente ndarjen e çështjeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; (ii) subjekti ka qenë në funksionin e prokurorit në vitin 2014 kur shtetasi F.D. është proceduar për herë të dytë.

69. Sa më sipër, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2, ka pyetur subjektin nëse ka pasur kontakte në formën e një takimi, komunikimi elektronik, telefonik, apo nëse ka udhëtuar apo është shoqëruar me shtetasin F.D.

70. Në përgjigje të tij, subjekti ka deklaruar se: *“Në dijeninë time shtetasin F.D. e njoh thjesht si pronar i një restoranti në zonën e R. ku kam shkuar për evente si fejesë, dasma apo ditëlindje të të njohurve të mi. Pasi ka qenë një nga lokalet më të frekuentuara të qytetit të Vlorës për evente të tilla. Në dijeninë time nuk kam pasur ndonjëherë kontakt në formën e një komunikimi elektronik, telefonik, të kem udhëtuar apo shoqërohem me këtë person. Takimet me të kanë qenë vetëm rastësore në raportin pronar-klient për ato pak herë që kam shkuar në këtë lokal. Prej shumë vitesh nuk kam frekuentuar më këtë lokal dhe nuk kam më dijeni për këtë person”.*

71. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me konstatimin se subjekti i rivlerësimit: (i) është shoqëruar me shtetasin F.D. edhe pse ka qenë në dijeni të problemeve të tij me ligjin, ku ky i fundit rezulton i proceduar, dyshuar dhe dënuar disa herë; (ii) nuk ka qenë i sinqertë në deklaratimet e tij para Komisionit, ku ka mohuar faktin se ka pasur kontakt në formën e takimit, udhëtimit apo shoqërimit me shtetasin F.D.

72. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se *procedimi penal ndaj shtetasit F.D. është regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë përpara se të emërohej drejtues i kësaj prokurorie. Gjithashtu, edhe procedimi penal i vitit 2014 është regjistruar në kohën kur nuk ushtronte detyrën e drejtuesit. Si rrjedhojë, nuk e ka përcaktuar ai prokurorin që do të ushtronte ndjekjen penale në rastin konkret dhe nuk ka ushtruar asnjëherë ndjekjen penale në procedimet në ngarkim të këtij shtetasi.*

73. Subjekti ka sqaruar se ky udhëtim ka qenë një rast sporadik, udhëtim njëditor në Kosovë dhe për shkak të kohës së gjatë, pasi kanë kaluar më shumë se 7 vite, në momentin që është pyetur nga Komisioni nuk kujtonte që ka qenë prezent edhe shtetasi F.D. Ky udhëtim është kryer në vitin 2013, përpara se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë të regjistrohej procedimi penal i vitit 2014 dhe procedimi mbi bazën e akteve të dërguara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, si dhe nuk ka pasur dijeni për këtë të fundit. Më tej shton se ka pranuar dhe deklaruar njohjen me këtë shtetas dhe se nuk ka pasur marrëdhënie tjetër përveç sa ka deklaruar. Që prej asaj periudhe dhe deri më sot subjekti deklaron se nuk ka pasur më kontakt me këtë shtetas.

74. Subjekti, gjatë seancës dëgjimore, në lidhje me këtë konstatim, ka deklaruar gjithashtu se: *“[...] unë nuk e kam mohuar faktin se këtë person e njoh, pavarësisht se unë e njoh me tjetër emër, por duke pyetur dhe për të qenë i drejtë dhe i sinqertë dhe sa më sqarues, e kam njohur*

kur kam vajtur me punë më mbrapa në qytetin e Vlorës për shkak se ishte pronar i një restoranti ku frekuentohej nga shumë persona me integritet, pasi ka qenë lokal që zhvilloheshin edhe ceremoni fejeje, dasmash, vinin organizoheshin takime të ndryshme. Ky ka qenë momenti i njohjes me këtë person. Në lidhje me këtë udhëtim unë s'kam pasur fare arsye përse ta fsheh, por ka qenë një kohë e largët dhe një udhëtim sporadik dhe unë as e mbaj mend dhe as e kujtoj që të kemi qenë në të njëjtën makinë. Unë kam qenë me tre shokët e mi i ftuar në një festë nga një miku im në Prishtinë dhe duke qenë se kolegu im shfaqti dëshirën që të vinte edhe ai, t'i bashkohej edhe ai udhëtimin tonë, i cili ka qenë me këtë person, të ndodhur para një fakti të tillë nuk kam menduar d.m.th. se do të përbënte ndonjë problem, por sinqerisht nuk e kujtoj dhe nuk e mbaj mend që ne të kemi qenë në të njëjtën makinë. Shpeshherë gjatë kalimeve kufitare, për shkak të rrëmujës dhe procedurave që kryejnë punonjësit e policisë atje, nuk vendosen vulat, harrojnë [...]. Ndofta ato kanë qenë kalime afër njëra-tjetrës dhe është bërë regjistrimi i gabuar në emër të atij personi. Tani, unë sinqerisht nuk e mbaj mend”.

Arsyetimi i Komisionit

75. Referuar raportit të dërguar nga DSIK-ja, provave shkresore të administruara gjatë hetimit, sipas kërkesave të neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore, Komisioni arsyeton se:

76. Pretendimi i subjektit se *procedimi penal ndaj shtetasit F.D. është regjistruar në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Vlorë përpara se ai të emërohej drejtues i kësaj prokurorie dhe nuk ka pasur dijeni se ky shtetas ka qenë i proceduar*, nuk është bindës. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi në mënyrë të besueshme mospasjen dijeni të faktit se shtetasi F.D. ishte proceduar nga Prokuroria e Rrethit Vlorë për vlerën penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, pasi: (i) nga provat e administruara vërtetohet se procedimi penal ndaj këtij shtetasi është regjistruar në 28 nëntor të vitit 2011, për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake” pranë prokurorisë; (ii) subjekti i rivlerësimit ka qenë Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nga nëntori i viti 2011 deri në shkurt të vitit 2013, vërtetuar me deklaratimet e vetë subjektit në formularin e vetëvlerësimit profesional, i cili deklaroi se nga nëntori i vitit 2011 deri në shkurt të vitit 2013 ka qenë Drejtues i Prokurorisë, me shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2021; si dhe (iii) subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues se nuk ka qenë ai që ka bërë ndarjen e këtij procedimi tek prokurori përkatës.

77. Më tej, nga aktet e administruara në dosje rezulton se shtetasi F.D. në datën 16.11.2013 është referuar nga policia si pjesë e grupit kriminal dhe është akuzuar nga organi i akuzës për veprën penale “trafikim të narkotikëve”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, prokuroria ku ushtronte funksionin edhe subjekti i rivlerësimit. Për më tepër që, vetëm 3 javë nga ky referim i policisë (datë 16.11.2013), subjekti i rivlerësimit, prokuror pranë prokurorisë ku edhe ishte referuar ngjarja për trafikim të narkotikëve ndaj këtij shtetasi, udhëton drejt Kosovës bashkë me këtë shtetas dhe të tjerë.

78. Përveç udhëtimit, nga informacionet pranë organeve ligjzbatuese, të cilat nuk mund të bëhen publike pasi janë informacion i klasifikuar “sekret shtetëror” rezulton se midis subjektit dhe këtij shtetasi ka pasur edhe komunikime telefonike. Kontaktet telefonike dhe udhëtimi drejt Kosovës, ndonëse kanë ndodhur gjatë kohës që ky shtetas nuk ka qenë në cilësinë e personit të akuzuar, por të një personi të dyshuar për përfshirje në këtë aktivitet, vlerësohen nga Komisioni

si rrethana të cilat konfirmojnë se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të faktit se shtetasi F.D. do të ishte i pranishëm në këtë udhëtim, siç edhe u konfirmua nga subjekti gjatë seancës dëgjimore⁶⁰. Për më tepër që në aspektin kohor vlen të theksohet se udhëtimi me këtë shtetas nuk ka qenë rastësor, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i plotë në lidhje me deklarin e këtij udhëtimi, si dhe komunikimin telefonik me këtë shtetas në kohën që është pyetur nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ kryesisht.

79. Më tej, në lidhje me këtë shtetas, në datën 26.9.2014 është hetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku subjekti ka qenë në pozicionin e prokurorit, për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal, çështje e hetuar nga prokurori K. Ll.

80. Duke analizuar deklarinimet e subjekti gjatë hetimit, por edhe gjatë seancës dëgjimore, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) konfirmon se e njeh këtë shtetas, por nuk parashtrroi në mënyrë të besueshme se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në procedime të ndryshme penale; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet që ka pasur me këtë shtetas, pasi nuk konfirmoi gjatë hetimit udhëtimin që kishte pasur në shoqërinë e këtij shtetasi në Kosovë dhe nuk deklaroi se kishte pasur komunikim telefonik sipas të dhënave të Komisionit; (iii) subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në deklarinimet e tij karshi njohjes me këtë shtetas, fakt i cili Komisionit i krijon bindjen se subjekti mund të ketë qenë në dijeni të faktit se shtetasi F.D. do të ishte i pranishëm në udhëtimin në Kosovë, çka nuk të krijon bindjen se ky udhëtim ka qenë rastësor, në datën 7.12.2013.

81. Në përfundim, Komisioni vlerëson se konkluzionet e renditura më lart duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për besueshmërinë e deklarinimeve të subjektit dhe pikës 5 të nenit 61, duke cenuar besimin që publiku tek drejtësia.

82. Në vijim të hetimeve, Komisioni kërkoi informacion pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë⁶¹ në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga viti 2006 e deri më sot. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 18.1.2021, të ILD-së, rezultojnë 2 ankesa të paraqitura nga shtetasi D.H.⁶². Ankuesi, me profesion avokat, deklaroi se është konfliktuar dhe goditur nga shtetasi V.A. dhe dy djemtë e tij E. dhe E.A. dhe se subjekti i rivlerësimit, duke qenë mik i ngushtë me ta, ka ndërhyrë për ta klasifikuar veprën si plagosje të thjeshtë dhe jo si goditje për shkak të detyrës, duke shmangur nga përgjegjësia penale bashkëpunëtorët.

83. Lidhur me sa pretendohet, në Komision u administrua⁶³ kërkesa për gjykimin e çështjes penale nr. ***, me të pandehur V.A., akuzuar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 dhe 25 të Kodit Penal. Gjithashtu është kërkuar informacion nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶⁴ lidhur me procedurën e hedhjes

⁶⁰Sipas procesverbalit të mbajtur në seancën dëgjimore.

⁶¹Shkresë nr. *** prot., datë 13.1.2021.

⁶²Ankesat nr. *** prot., datë 31.12.2019, dhe nr. *** prot., datë 24.2.2020 (ankesë e përsëritur).

⁶³Shkresë nr. *** prot., datë 17.6.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁶⁴Shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2021.

së shortit për këtë çështje. Në përgjigje⁶⁵ të saj, prokuroria informon se në këtë periudhë shpërndarja është bërë nga drejtuesi sipas gatishmërisë mujore. Në datën 30.1.2012 subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, ka nxjerrë urdhër për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Me hetimin e këtij procedimi penal ka ngarkuar prokurorin A.K. dhe OPGJ-në O.B.

84. Rrethanat e faktit – rezulton se konflikti midis shtetasve D.H. dhe V.A. ka lindur për shkak të mosmarrëveshjeve të pronësisë. I pandehuri V.A. ka kërkuar nga i dëmtuari D.H. të largohet nga prona ku ky i fundit po bënte matje, me arsyetimin se nuk ishte pronë e tij. Në këtë moment ka lindur një konflikt fizik midis tyre, ku i pandehuri V.A. e ka goditur me grushte dhe sende të forta, duke i sjellë dëmtime që shkaktojnë humbje të aftësisë së përkohshme në punë, në masën 9 ditë. Në datën 25.1.2012 shtetasi V.A. ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasit D.H. për ushtrim dhune. Sipas aktekspertimit mjeko-ligjor nr. ***, datë 26.1.2012, këto dëmtime kanë shkaktuar humbje të aftësisë së përkohshme në punë, në masën 9 ditë. Nga materiali referues, rezulton se edhe shtetasi D.H., në datën 26.1.2012 ka paraqitur kallëzim ndaj shtetasit V.A., duke pretenduar se ky i fundit, bashkë me tre persona të tjerë kanë ushtruar dhunë ndaj tij. Sipas aktekspertimit mjeko ligjor nr. ***, datë 26.1.2012, rezulton se këto dëmtime kanë shkaktuar humbje të aftësisë së përkohshme në punë, në masën 9 ditë. Në kuptim të ligjit penal, shkalla e këtyre dëmtimeve klasifikohet si vepër penale “plagosje e lehtë me dashje”, vepër kjo që ndiqet me ankim të të dëmtuarit. Në përfundim të hetimeve prokurori i çështjes ka përpiluar kërkesën për gjykimin e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, me të pandehur V.A. Prokurori analizon se goditja dhe përdorimi i dhunës ndërmjet palëve nuk ka ardhur për shkak të cilësive të veçanta që gëzon shtetasi D.H., pasi rezulton se ky shtetas bashkë me ekspertin nuk kishin shkuar të bënin matje si pasojë e detyrimit të ndonjë vendimi gjyqësor. Matjet e pronës janë bërë në kuadër të veprimeve private dhe me qëllim që t'i përdornin në proces gjyqësor. Prokuroria vlerëson se veprimet e ndërmarra ndaj shtetasit D.H., nuk janë kryer për shkak të veprimtarisë apo detyrës së tij. Vetëm fakti se i dëmtuari është përfaqësues ligjor me prokurë i një subjekti nuk e bën atë subjekt të posaçëm që të gëzojë mbrojtje juridike, parashikuar nga neni 316⁶⁶ i Kodit Penal. Në konkluzionet përfundimtare të datës 12.6.2012 ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit V.A. për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, duke e dënuar me 90.000 lekë gjobë. Gjykata, në caktimin e dënimit, të marrë parasysht zbatimin e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, duke ulur një të tretën e masës së dënimit.

85. Duke marrë në konsideratë faktin se: (i) subjekti i rivlerësimit ka një marrëdhënie interesi me shtetasin V.A., pasi prej vitit 2009 jeton në apartamentin me qira të ndodhur në godinën në pronësi të tij; (ii) hetimet për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje” janë kryer gjatë kohës që subjekti jetonte në banesën e marrë me qira; (iii) në këtë kohë (viti 2012) subjekti ka qenë në pozicionin e drejtuesit dhe bënte shpërndarjet e çështjeve pranë prokurorëve përkatës; (iv)

⁶⁵Shkresë nr. *** prot., datë 8.7.2021.

⁶⁶“Kundërshtimi me dhunë, goditjet dhe vepra të tjera dhune që i bëhen gjyqtarit apo anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit, ekspertëve, çdo arbitri të caktuar për një çështje, për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të saj, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.”

dënimi i kërkuar nga prokuroria për shtetasin V.A. ka qenë në minimumin e masës së dënimit, sipas nenit 89 të Kodit Penal (gjobë 90.000 lekë).

86. Referuar fakteve të renditura më sipër, Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me: (i) procedurën e ndjekur nga subjekti për kalimin e këtij procedimi penal prokurorit A.K., duke provuar shpërndarjen sipas ngarkesës apo gatishmërisë mujore; (ii) ka dyshime se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ndikim të paligjshëm ndaj prokurorit të çështjes për favorizimin e shtetasit V.A., duke pasur parasysh se në konkluzionet përfundimtare të datës 12.6.2012 prokuroria ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit V.A. për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, duke e dënuar vetëm me 90.000 lekë gjobë.

87. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se *ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e materialeve të referuara nga policia gjyqësore, mbi bazën e dy ankimeve të shtetasve V.A. e D.H., të cilët anoheshin ndaj njeri-tjetrit. Si rregull prokurori që do të ushtronte ndjekjen penale përcaktohej sipas listës së gatishmërisë e cila miratohej në fillim të çdo muaji dhe, në raste të veçanta, në bazë të ngarkesës që kishte çdo prokuror. Nga kërkimet e bëra në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk gjendet e ruajtur lista e gatishmërisë së këtij muaji, por duke u nisur nga rregulli i përgjithshëm subjekti sqaron se përcaktimi i prokurorit është kryer sipas këtij rregulli. Vepra penale “plagosje e lehtë me dashje” parashikohet në Kod si kundërvajtje penale (pra, vepër penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët), e cila ndiqet vetëm mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit. Bazuar në jurisprudencën e gjykatave penale shqiptare, lloji i dënimit i aplikuar gjerësisht për këtë lloj vepre penale, kur personat nuk janë të dënuar më parë, është ai me gjobë. Subjekti paraqiti në cilësinë e provës disa vendime gjyqësore ku është aplikuar ky lloj dënimi për personat e akuzuar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”. Referuar vendimit nr. ***, datë 28.6.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarinim fajtor të shtetasit V.A. dhe dënimin e tij me gjobë. Në konkluzionet e prokurorit të çështjes në mënyrë shumë të detajuar janë përcaktuar rrethanat, kushtet dhe kriteret që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit. Lloji dhe masa e dënimit e përcaktuar në rastin konkret është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore të neneve 47 dhe 49 të Kodit Penal.*

Arsyetimi i Komisionit

88. Referuar raportit të dërguar nga DSIK-ja, provave shkresore të administruara gjatë hetimit, sipas kërkesave të neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore, Komisioni arsyeton se:

89. Pretendimi i subjektit se si rregull prokurori që do të ushtronte ndjekjen penale përcaktohej sipas listës së gatishmërisë e cila miratohej në fillim të çdo muaji dhe në raste të veçanta në bazë të ngarkesës që kishte çdo prokuror, nuk u provua nga subjekti dhe mbetet vetëm në aspektin deklarativ.

90. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues procedurën e ndjekur në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Vlorë për kalimin e këtij procedimi penal prokurorit A.K., duke provuar shpërndarjen sipas ngarkesës apo gatishmërisë mujore. Në këto kushte, Komisioni i qëndron dyshimit se subjekti i rivlerësimit mund të ketë shpërndarë këtë çështje në ngarkim të shtetasit V.A., prokurorit të cilit ai vetë ka zgjedhur me qëllim që të kishte një kualifikim më të lehtë sa parashikonte norma përkatëse e Kodit Penal.

Ky dyshim lidhet me faktin që subjekti i rivlerësimit kishte asokohe (dhe ka edhe aktualisht) marrëdhënie qiraje me shtetasin e proceduar V.A., person nën hetim, pasi ai qëndronte me qira tek ndërtesa e tij.

91. Kjo rrethanë faktike e vlerësuar në raport me qëndrimin në mënyrë të vazhdueshme të subjektit në banesën me qira në pronësi të shtetasit V.A. dhe perceptimin e gabuar që ka dhënë tek i dëmtuari, fakti që subjekti si Drejtues i Prokurorisë jetonte në të njëjtin vend ku dhe ishte i proceduari për plagosje të lehtë, kanë ndikuar në perceptimin e të dëmtuarit se ky shtetas është favorizuar nga subjekti i rivlerësimit.

92. Komisioni vlerëson se fakti që subjekti i rivlerësimit banonte me qira në godinën e shtetasit V.A., ku dhe vetë ky i fundit banonte në një kat tjetër të kësaj godine në pronësi të tij, të krijon dyshime mbi paanësinë në ushtrimin e detyrës së subjektit në rolin e drejtuesit, në lidhje me procesin e shpërndarjes së kësaj çështjeje tek prokurori i cili mund të ndikohet nga subjekti për shkaqe të ndryshme.

93. Fakti që prokurori i caktuar nga subjekti A. K. ka kërkuar deklarin fajtor të të pandehurit V.A. për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, duke e dënuar vetëm me 90.000 lekë gjobë, në analizë të sa më sipër mund të krijojë dyshime se ky shtetas ka pasur favorizim në trajtimin e çështjes së tij nga ana e prokurorisë, duke qenë se është aplikuar minimumi i masës së parashikuar në ligj.

94. Duke marrë në konsideratë faktet se: (i) subjekti i rivlerësimit ka një marrëdhënie interesi me shtetasin V.A., pasi jeton me qira në një apartament në godinën në pronësi të tij nga viti 2009; (ii) gjatë kohës së qëndrimit në banesën e këtij shtetasi, nga Prokuroria e Rrethit Vlorë kryheshin hetime për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje” për qiradhënësin; (iii) në këtë kohë (viti 2012) subjekti ka qenë në pozicionin e drejtuesit dhe bënte shpërndarjet e çështjeve pranë prokurorëve përkatës; (iv) dënimi i kërkuar nga prokuroria për shtetasin V.A. ka qenë në minimum të masës së dënimit, sipas nenit 89 të Kodit Penal, gjobë 90.000 lekë, rrethanë kjo e cila, e parë së bashku me problematikat e evidentuara më herët, mund të çojë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e të dëmtuarit te sistemi i drejtësisë. Në përfundim, Komisioni vlerëson se konkluzionet e renditura më lart duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 5 të nenit 61.

95. Komisioni kërkoi administrimin e fashikujve të procedimit penal në ngarkim të të pandehurit N.A., akuzuar për veprat penale “heqje e paligjshme të lirisë” dhe “plagosje e lehtë me dashje”.

96. Rrethanat e faktit – nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera dhe materialet e administruara në funksion të këtij procedimi penal, ka rezultuar e provuar se në datën 5.9.2015 në fshatin R. është goditur me mjete të forta shtetasi S.A., i cili ishte duke u transportuar për në Spitalin Rajonal Vlorë. I dëmtuari kishte hipur në një automjet të drejtuar nga shtetasi N.A. për t’u sqaruar lidhur me problemin që kishin, ku pas 200 m rrugëtim automjeti ka ndaluar dhe në të kanë hipur dy persona të tjerë, njëri prej tyre ka filluar të godasë në fytyrë shtetasin S.A. me qytën e një arme zjarri, pistoletë. Automjeti ka filluar lëvizjen në drejtim të O. dhe gjatë rrugës, sipas të dëmtuarit, edhe personi tjetër i cili ishte në automjet në sediljen e pasme e ka goditur me një shkop gome në pjesën e fytyrës dhe në kokë. Pasi e kanë keqtrajtuar, automjeti ka ndaluar në fshatin Dukat -Fushë dhe personat e kanë zbritur të dëmtuarin duke e lënë në anë

të rrugës. Në kallëzimin e tij, i dëmtuari shprehet se personi që e kishte goditur me qytë pistolete quhej L. dhe ishte nga Vlora, kurse për personin e tretë që e goditi me shkopin e gomës dinte vetëm që ishte banor i Vlorës. Nga të dhënat operative të siguruar dhe informacionet e mbledhura nga policia gjyqësore rezultoi se personi me emrin L. është shtetasi T.B., lindur dhe banues në Vlorë. Nga të dhënat ka rezultuar se të dyshuarit si autorë të ngjarjes, shtetasit N.A. dhe T.B., janë larguar duke ju fshehur policisë. Janë kryer kontrollat e banesave dhe janë bërë kërkime për të dy këta shtetas, të cilët janë shpallur në kërkim.

97. Veprimet hetimore – për të grumbulluar të dhënat e nevojshme lidhur me përcaktimin e faktit dhe të veprës penale, si dhe për individualizimin e përgjegjësisë penale dhe të personit që ka kryer veprën, subjekti në datën 15.9.2015 ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e këtyre veprimeve hetimore: (i) të administrohet aktekspertimi mjeko-ligjor i shtetasit S.A., si dhe tabelat fotografike të këqyrjeve; (ii) të pyetet dhe të merren deklarime të hollësishme prej të dëmtuarit S.A., ku të sqarohen rrethanat e ngjarjes para dhe pas saj; (iii) të përshkruhen më saktë karakteristikat e personave të tjerë të dyshuar si pjesëmarrës në ngjarje; (iv) nëse është e mundur, të bëhet paraqitja për njohje nëpërmjet fotografisë e personave të dyshuar të përfshirë në ngjarje; (v) të verifikohet nëse ka persona të tjerë me dijeni për rrethanat e faktit dhe të merren deklarime për dijeninë e tyre; (vi) të mbahet dhe përpilohet procesverbal mbi kërkimet e të dyshuarve dhe një raport mbi to; si dhe (vii) të kryhet çdo veprim tjetër hetimor që mund të dalë gjatë hetimeve të çështjes, duke u vënë më parë në dijeni prokurori i çështjes.

98. Nga aktekspertimi mjeko-ligjor nr. ***, datë 8.9.2015, është konkluduar se i dëmtuari S.A. ka shembje të kokës dhe trupit, thyerje të kockës së hundës, shembje e kokërdhokut të syrit, të cilat janë shkaktuar me mjet brejtës dhe këto dëmtime hyjnë në kategorinë e dëmtimeve që sjellin humbjen e aftësisë së parakohshme për punë, në masën mbi 9 ditë. Nga hetimet e zhvilluara u provua se shtetasit N.A. dhe T.B., në bashkëpunim me njëri-tjetrin në marrëveshje paraprake, me veprimet e tyre të kundërligjshme në dëm të shtetasit S.A. kanë kryer veprën penale “plagosje e lehtë”, parashikuar nga nenet 89 e 25 të Kodit Penal dhe veprën penale “heqje e paligjshme e lirisë”, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal. Këto veprime konsistojnë në marrëveshjen midis shtetasve N.A. e T.B. dhe personit tjetër të paidentifikuar, me qëllim marrjen në automjet me forcë dhe në kundërshtim me vullnetin e të dëmtuarit, për të ushtruar dhunë ndaj tij, të cilat nga aktet provohet se janë konkluduar. Akuza rezulton e provuar nga të gjitha materialet dhe provat shkresore të administruara në fashikullin hetimor të kësaj çështjeje (procesverbali i këqyrjes së automjetit dhe sekuestrimit të provave materiale, aktekspertimi mjeko-ligjor, procesverbalet e kontrollit të banesave, procesverbalet e deklarimeve të personave që tregojnë rrethana hetimi, etj.).

99. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, në datën 4.3.2016 ka kërkuar gjykimin e çështjes penale dhe në konkluzionet përfundimtare ka kërkuar: - *Deklarimin fajtor të të pandehurit N.A. për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 200.000 lekë gjobë, si dhe kryerjen e veprës penale “heqje e paligjshme të lirisë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet e 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e tij me 4 vjet e 6 muaj burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3.* - *Deklarimin fajtor të të pandehurit T.B. për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje” dhe dënimin e tij me 200.000 lekë gjobë, si dhe kryerjen e veprës*

penale “heqje e paligjshme të lirisë”, në bashkëpunim dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3.

100. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. regj. them. ***, datë 11.4.2016, vendosi: - Deklarimin fajtor të të pandehurit N.A. për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje” dhe dënimin e tij me 200.000 lekë gjobë. Deklarimin fajtor të të pandehurit N.A. për kryerjen e veprës penale “heqje e paligjshme të lirisë”, në bashkëpunim dhe dënimin e tij me 4 vjet e 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e tij me 4 vjet e 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet zbritja e 1/3 së dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për një periudhë kohore prej 2 vitesh. Në aplikim të nenit 61 të Kodit Penal, urdhërohet i pandehuri N.A. që të paraqitet pranë Shërbimit të Provës dhe të marrë pëlqimin nga Shërbimi i Provës për ndryshimin e vendbanimit apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i tij nga institucioni ku mbahet i paraburgosur, nëse ndaj tij nuk ka një vendim dënimi me burgim apo masë tjetër sigurimi personal. - Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit T.B. për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”, dhe veprës penale “heqje e paligjshme të lirisë”, në bashkëpunim.

101. Pas analizimit të dosjes penale, Komisioni vëren se subjekti nuk është shprehur lidhur me veprimet e kryera nga organi i akuzës për identifikimin e personit të tretë që ka ushtruar dhunë ndaj të dëmtuarit S.A. Referuar urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, subjekti ka kërkuar të përshkruhen saktë karakteristikat e personave të tjerë të dyshuar si pjesëmarrës në ngjarje, të bëhet paraqitja për njohje nëpërmjet fotografisë për personat e dyshuar të përfshirë në ngjarje, të verifikohet nëse ka persona të tjerë me dijeni për rrethanat e faktit, si dhe të merren deklarime për dijeninë e tyre. Por, në përfundim, nuk është paraqitur asnjë veprim i kryer lidhur me hetimet për identifikimin e personin e tretë që ka ushtruar dhunë.

102. Për sa rezultoi nga hetimi, Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me konstatimet se: (i) subjekti i rivlerësimit duket se ka favorizuar dy të akuzuarit, duke qenë se për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje” ka kërkuar aplikimin e masës së dënimit më të lehtë, atë me gjobë, sipas nenit 89 të Kodit Penal; dhe (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore lidhur me identifikimin e personit të tretë që ka ushtruar dhunë ndaj të dëmtuarit S.A.

103. Subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se kryerja e veprimit procedural të paraqitjes për njohje të shtetasve të akuzuar nuk ka qenë e nevojshme, ndërsa për personin e tretë i cili përmendet në mënyrë shumë të përgjithshme nga kallëzuesi nuk mund të kryhej paraqitje për njohje, për shkak se nga veprimet operative të kryera nga policia gjyqësore nuk është identifikuar asnjë shtetas i dyshuar. Pra, duhet të ketë një person të dyshuar (i cili identifikohet si rregull në mënyrë operative nga policia), i cili të paraqitet për njohje (personalisht apo me fotografi) së bashku me disa shtetas të tjerë. Gjatë hetimit të çështjes është ripyetur kallëzuesi dhe ashtu si në deklaratimet e tij fillestare nuk ka dhënë të dhëna identifikuese të rëndësishme për personin e tretë. Janë pyetur gjatë hetimit edhe të gjithë personat që rezultuan se kishin dijeni për ngjarjen konkrete dhe nuk është marrë asnjë e dhënë identifikuese për personin e tretë. Edhe nga tabulatet telefonike të administruara nuk është bërë e mundur të merren të dhëna për identifikimin e shtetasit të tretë, duke e bërë të pamundur.

104. Subjekti shprehet se ka kërkuar deklarinim fajtor dhe dënimin e të pandehurve me një lloj dhe masë dënimi përfundimtare të ashpër në përputhje me rrezikshmërinë e veprimeve të kryera prej tyre, sipas përcaktimeve të nenit 47 të Kodit Penal. Ndryshe nga sa konstaton Komisioni, ka kërkuar dënim të ashpër penal, me burgim në një masë të konsiderueshme, 4 vjet e 6 muaj, por gjykata ka aplikuar për shtetasin N.A. pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe ka deklaruar të pafajshëm shtetasin T.B. Në këto kushte ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Arsyetimi i Komisionit

105. Referuar raportit të dërguar nga DSIK-ja, provave shkresore të administruara gjatë hetimit, sipas kërkesave të neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore, Komisioni arsyeton se:

106. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm lidhur me pamundësinë dhe moskryerjen e veprimeve hetimore që lidheshin me identifikimin e personit të tretë që ka ushtruar dhunë ndaj të dëmtuarit S.A.

107. Pretendimi i subjektit se ka kryer të gjitha veprimet hetimore të mundshme, nuk u provua me dokumentacion provues, por ishte vetëm në nivel deklarativ, duke e vënë subjektin në kushtet e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

108. Në lidhje me masën e dënimit të propozuar nga prokurori, subjekti provoi se ai kishte ankuar vendimin e gjykatës për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim të shtetasit N.A., si dhe ka ankimuar vendimin e gjykatës për deklarinim të pafajshëm shtetasin T.B.

109. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka kryer të gjithë hapat hetimorë për identifikimin e personit të tretë që ka ushtruar dhunë ndaj të dëmtuarit S.A. dhe se kjo mangësi hetimore duhet marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzioni mbi konstatimet e tjera të Komisionit

Në vlerësimin tërësor të problematikave të analizuara më lart, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzioni Përfundimtar

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarinim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, bazuar në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve Ç, D, DH dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Erion Çelaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj